

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MSc në Shkenca juridike me drejtime:

- Marrëdhënie ndërkombëtare
- E drejtë publike dhe administrative
- E drejtë private
- E drejtë ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian
- E drejtë penale

Universiteti Privat Albanian University

Ekspertet e Vlerësimit të Jashtëm:
Prof. Asoc. Dr. Enkeleda OLLDASHI
Prof. Asoc. Dr. Mirela P. BOGDANI

Enkeleda Ollolashi
Mirela Bogdani

(Tetor 2016)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MSc në Shkenca juridike me drejtime:

- Marrëdhënie ndërkombëtare
- E drejtë publike dhe administrative
- E drejtë private
- E drejtë ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian
- E drejtë penale

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat Albanian University
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 408, datë 26.05.2010
4	Titulli i programit të studimit:	Msc Shkenca juridike me drejtime; <ul style="list-style-type: none"> • Marrëdhënie ndërkombëtare • E drejtë publike dhe administrative • E drejtë private • E drejtë ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian • E drejtë penale
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë i studimit
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	-
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
15	Aktivizimi i programit të studimit	2011 - 2012
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2012 - 2013
17	Numri i studentëve të regjistruar për këtë program studimi	211

HYRJE

Në bazë të VKM Nr.408, datë 26.5.2010 “Për hapjen e programeve të reja të studimeve në Shkollën e Lartë Private “UFO University”, Tiranë” janë hapur programet e studimeve të ciklit të dytë (me 120 kredite) me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike me diplomë DND. Ky raport përmban gjetjet e vlerësimit të jashtëm të kryer në kuadrin e kërkesës së Universitetit Privat Albanian University për akreditimin e programit të studimeve “Msc në Shkenca Juridike me profilet:

- Marrëdhënie ndërkombëtare
- E drejtë publike dhe administrative
- E drejtë private
- E drejtë ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian

- E drejtë penale

Universiteti Privat Albanian University, me shkresë Nr. 53/79 prot, datë 13.10.2016 ka sjellë në APAAL, përgjigje për draft raportin e vlerësimit të jashtëm. Ekspertët pasi lexuan me kujdes përgjigjet nga Institucioni nuk morën parasysh komentet mbi Draft – Raportin, duke mos ndryshuar asgjë në raportin përfundimtar.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. Asoc. Dr. Enkelelda OLLDASHI
Prof. Asoc. Dr. Mirela P. BOGDANI

Ky grup u asistua nga specialistja e APAAL Znj. Majlinda Demirneli.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Në bazë të Urdhërit Nr. 52, datë 05.02.2016, të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve “Për riorganizimin Institucional të Universitetit Privat “Albanian University”, ky institucion ka në përbërjen e tij tre njësi kryesore: a) Fakultetin e Shkencave Shoqërore; b) Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë; c) Fakultetin e Shkencave Mjekësore. Në bazë të VKM Nr.408, datë 26.5.2010 “Për hapjen e programeve të reja të studimeve në Shkollën e Lartë Private “UFO University”, Tiranë” janë hapur programe studimesh të ciklit të dytë (me 120 kredite) me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike; me drejtimet: a) Marrëdhënie ndërkombëtare; b) E drejtë publike dhe administrative; c) E drejtë private; ç) E drejtë ndërkombëtare dhe Bashkimi Evropian; d) E drejtë penale. Qëllimi i programeve të studimit Msc “Në Shkenca Juridike” (sipas profileve përkatëse) është: a) pajisja e studentëve me njohuritë specifike në fushat më kryesore të së drejtës; b) aftësimi për veprimtari kërkimore-shkencore; c) përdorimit efikas të teknologjisë së informacionit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	<ul style="list-style-type: none"> • Programet e studimit Msc të ofruara nga Departamenti i Shkencave Juridike, janë përshtatur me kapacitetet akademike të institucionit. Kapaciteti dhe përvoja akademike e stafit duhet të kenë ndikuar më së shumti në përmbajtjen e kurikulës së programit Master i Shkencave në “Shkenca Juridike” sipas profileve:
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmblendhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

<p>përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - E drejta publike - E drejta private - E drejta penale - E drejta ndërkombëtare dhe BE - Marrëdhëniet ndërkombëtare *Pranë Departamenti të Shkencave Juridike aktualisht janë aktive dy prej profileve të licensuara: <ul style="list-style-type: none"> - E drejtë penale - E drejtë private <p>●Nevojat e tregut dhe të ekonomisë në vendin tonë nuk janë anashkaluar në hartimin e çdo programi studimi Msc, pasi trupa akademike ka hartuar plan-programe mesimore në funksion të asaj që tregu dhe ekonomia në tërësi kërkon. Edhe pse në vendin tonë përgjithësisht mungojnë studimet e plota e të detajuara të treguesve të tregut të punës stafi akademik në hartimin kurrikulave ka mbajtur parasysh trendet dhe zhvillimet e kohës në lëmin e drejtësisë private dhe penale.</p>
---	---

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>●Programet e studimit Msc “Në Shkenca Juridike” (sipas profileve përkatëse), tregojnë për një përshtatje me strategjinë e vet universitetit në tërësi, pasi komponentë të caktuar të programit janë përmirësuar dhe në funksion të strategjisë së tij. Strategjia e këtij universiteti në tërësinë e saj është e lidhur me komponentet e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në plan-programet e lëndëve janë përfshirë komponentë vlerësuese që lidhen me punën e pavarur të studentëve deri në masën 20%.</p>
---	--

Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>● Nga përmbajtja e programit të studimit (sipas profileve) kriteret e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore janë respektuar në masën 90%, pasi në asnjë nga programet e ofruara, praktika profesionale nuk ka zënë një vënd të dukshëm/ në volum orësh (në auditor dhe jashtë auditorit) . Ky komponent akademik duhet të ishte konstatuar që në fazën e hapjes dhe licensimit të secilit prej programeve të studimit, nga autoritet përkatëse licensuese. Drejtuesit e programit, me kapacitetin e tyre akademik dhe të stafit që është pjesë e programit të studimit (sipas profileve) e kanë përmbushur realizimin e këtij elementi strukturor të mangët në program me forma të tjera të aktiviteteve brenda dhe jashtë auditorit. Në cdo rast, ata duket të kenë koshiencën e duhur akademike për ta përmbushur</p>
--	---

Handwritten signatures and initials in blue ink.

këtë komponent akademiko- strukturë në një formë më të matshme dhe të vlerësueshme.

- Emërtimi i programeve të studimit Msc është në përshtatje me tërësinë e përmbajtjes së lëndëve që ofrohen në të gjitha profilet përkatëse.

Standardi I.11 – Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.

- Departamenti i Shkencave Juridike e ka materializuar strategjinë akademike, në lidhje me përmirësimin e programeve të studimit, mbi bazën e kapaciteteve njerëzore akademike dhe administrative. Ndërmjet punonjësve akademikë dhe administrativë janë ndërtuar lidhje bashkëpunimi në funksion të procesit akademik, të cilat gjykohen nga GVJ që duhet të funksionojnë përgjatë të gjithë procesit të mësimdhënies dhe nxënies.
- Për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies duhet të përdoren metodat e vlerësimit të stafit nga stafi, e cila rrit përgjegjësinë akademike të stafit nga njëra anë dhe nxit frymën e bashkëpunimit dhe ndërveprimin ndërmjet trupës akademike nga ana tjetër. Pyetsorët që institucioni përdor tek studentët, për vlerësimin e stafit dhe procesit akademik në tërësinë e tij si dhe të dhënat që dalin nga këta pyetësorë, natyrshëm ndikojnë në përmirësimin e procesit akademik dhe të rezultateve të mësimdhënies dhe nxënies. Institucioni përdor botimet shkencore dhe organizimin e konferencave shkencore për të nxitur mësimdhënien dhe nxënien.

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit Msc “Në Shkencat Juridike” (sipas profileve përkatëse) është përshtatur me strategjinë e universitetit në tërësi. Strategjia e këtij universiteti në tërësinë e saj është e lidhur me komponentet e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Në plan-programet e disa prej lëndëve janë përfshirë komponente vlerësuese që lidhen me punën e pavarur të studentëve edhe pse ato zënë një masë të vogël (deri në 20%), krahasuar me vlerën e vlerësimit përfundimtar të lëndës. Ky është një komponent vlerësimi që duhet të rritet në raport me komponentet e tjerë të vlerësimit, që parashikohen në plan-programet e lëndëve. Numri i vogël i studentëve e mundëson akoma më shumë këtë formë vlerësimi, pasi në nivelin e studimeve master, studentët duhet të bëjnë më shumë punë të pavarur.

Kapacitetet akademike si pjesë e këtyre programeve të studimit (sipas profileve përkatëse) dhe ato administrative të institucionit në tërësi, reflektohen në përmbajtjen e kurikulës . Këto kapacitete gjykohen si të rëndësishme për realizimin e programeve mësimore (sipas profileve përkatëse).

Pavarësisht respektimit në përgjithësi të kuadrit ligjorë, vlerësojmë që programet mësimore (sipas profileve) duhet të afrohen me tregun e punës në kuptimin e mirëfilltë të këtij koncepti, duke organizuar lëndën e praktikës profesionale në një formë më të normuar akademike. Në grupin e lëndëve të detyrueshme duhet të ketë një raport më të drejtë ndërmjet grupit të lëndëve që ju përkasin profileve më aktive.

Për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies duhet të përdoren edhe metodat e vlerësimit të stafit nga stafi, e cila do të risë përgjegjësinë akademike të stafit nga njëra anë dhe do të nxisë frymën e bashkëpunimit dhe ndërveprimin ndërmjet trupës akademike nga ana tjetër (në aspektin akademik dhe shkencorë). Pyetsorët që

Handwritten signatures and initials in blue ink.

NJSC përdorë tek studentët, për vlerësimin e stafit dhe procesit akademik në tërësinë e tij. Të dhënat që dalin nga këta pyetsorë, tregojnë për një transparencë të komponentëve mësimdhënies dhe nxënies. Këta pyetsorë, sigurisht që ndikojnë në përmirësimin e procesit akademik dhe të rezultateve të mësimdhënies dhe nxënies.
Standartet e mësipërme përmbushen plotësisht.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Departamenti i Shkencave Juridike, pranë të cilit është organizuar dhe programi i studimit i ciklit të dytë Msc në 'Shkenca Juridike', drejtohet nga përgjegjësi i departamentit, i cili ka gradën shkencore Phd (të fituar në Itali). Në përbërjen e programit të studimit Msc në "Shkenca Juridike" janë të angazhuar aktualisht 5 pedagogë efektivë (PAE) dhe 9 pedagogë me kontratë (PAK).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Universiteti ka në përbërjen e tij tre fakulte dhe një qendër të kërkimit shkencor. Qendra e Kërkimit Shkencor është një njësi e strukturuar në funksion të të gjitha njësive përbërëse bazë të këtij universiteti. Ajo drejtohet dhe funksionon përgjatë të gjithë periudhës akademike. Nga takimi me anëtarët e kësaj qendre dhe nga botimet shkencore që ajo realizon, mund të thuhet me bindje që personeli akademik dhe administrativ ka përkushtimin e mjaftushëm për realizimin e misionit kërkimor-shkencor. Kjo qendër realizon botimin e revistës shkencore (revistën periodike/dy herë në vit) "Optime". Revista ka një bord shkencor, në përbërjen e së cilit janë anëtrë të personelit akademik (efektiv dhe me kontratë) të të gjitha njësive bazë të institucionit si dhe profesorë të huaj, të cilët janë bashkëpunëtarë të institucionit. Sipas nenit 8 të rregullores së fakultetit: "Fakulteti i Shkencave Shoqërore", ka në përbërjen e tij katër departamente/njësi bazë : a) departamenti i Shkencave Juridike; b) departamenti i Shkencave Politiko-Administrative; c) departamenti i Psikologjisë dhe d) departamenti i Anglishtes dhe Edukimit. Autoritetet drejtuese të fakultetit janë : a) dekanin; b) zëvendës dekanët (sipas përcaktimit të Bordit) dhe; c) përgjegjësat e departamenteve.

Organet kolegjale janë:

- Këshilli i fakultetit, i cili në bazë të nenit 9 të rregullores së fakultetit ka në përbërjen e tij Dekanin, Zv.Dekanin, personelin akademik dhe një përfaqësues të studentëve për çdo program studimi.
- Këshilli i Etikës, në bazë të nenit 11 të rregullores së fakultetit, është një organ që funksionon edhe në bazë të një rregulloreje të posacme. Qëllimi i këtij organi është ruajtja dhe zbatimi i rregullave/parimeve të përcaktuara në Kodin e Etikës së institucionit.

Njësitë administrative të fakultetit janë: a) kancelari; b) asistentët e departamenteve; c) sekretaria mësimore dhe d) biblioteka.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	

Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;

Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;

Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë.

Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;

Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;

Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".

- Universiteti është i organizuar në përputhje me ligjin dhe me misionin e tij. Njësitë bazë janë dhe në funksion të njëra-tjetrës - në aspektin akademik dhe shkencor.

- Fakulteti i Shkencave Shoqërore, ku bën pjesë dhe Departamenti i Shkencave Juridike, ka në përbërjen e tij dhe tre departamente: Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme; Departamenti i Shkencave Polotiko-Administrative dhe Departamentin e edukimit.

Kjo përbërje njësisht bazë duket të ketë ndikuar mjaft pozitivisht në drejtim të punës shkencore të stafit – në kuadër të konferencave shkencore dhe botimit të artikujve shkencorë në revistën e universitetit. Shumë artikuj janë botuar në bashkëpunim me anëtarët e stafeve akademike të departamenteve të ndryshme, gjë që reflekton një tendencë të universitetit për të lidhur dhe ndërvepruar fushat e së drejtës me njëra-tjetrën si dhe disiplina të tjera me drejtësinë, duke i bërë botimet më atraktive dhe bashkëkohore.

- Departamenti i Shkencave Juridike ka numrin e mjaftushëm të stafit akademik dhe administrativ (17 PAE dhe 34 PAK). Trupa akademike ka titujt dhe gradadat shkencore të nevojshme për realizimin e programeve studimore dhe është në përputhje me kriteret e ligjit, ndërsa programi i studimit "Master Shkencor në Shkenca Juridike" ka në përbërje 5 PAE dhe 9 PAK (si pjesë e stafit të departamentit).

Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

- Njësitë bazë/autoritet drejtuese të universitetit janë të ndërgjegjshëm për rolin dhe misionin e tyre në realizimin formal dhe përmbajtësor të programeve të studimit Msc. Fryma e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të këtij procesi tregon për një barazpeshim të drejtë të rolit të gjithsecilit. Kjo frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie për procesin në tërësinë e tij është e dukshme në aspektin e transparencës për të rekrutuar dhe vlerësuar stafet akademike. Këto reflektohen në përcaktimin e kriterëve rigoroze gjatë procesit të rekrutimit të stafit, të shpërndarjes së informacionit për rekrutim në një komunitet të gjerë juristësh si dhe në faqen e internetit të universitetit, si dhe në procesin e intervistimit e më pas të përzgjedhjes të pedagogëve.

Konkluzionet e vlerësimit:

Departamenti i Shkencave Juridike është një ndër katër departamentet përbërëse të Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Bashkëpunimi ndërmjet departamentve të këtij fakulteti vlerësohet mjaft pozitivisht në drejtim të punës shkencore, e cila gjëndet e materializuar në artikujt shkencorë të botuara në revistën shkencore të universitetit (revista Optime: ISSN 2220-461X)

Stafi akademik i departamenti të Shkencave Juridike që është i përfshirë në realizimin e programeve të studimit Msc, ka kualifikimin e nevojshëm për realizimin e këtyre programeve studimore (sipas profileve

Handwritten signatures and initials in blue ink.

përkatëse) si dhe përkushtimin për të ofruar shërbimin më të mirë të mundshëm për studentët.
Standartet e mësipërme përmbushen plotësisht.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Në përpërje të trupës akademike të Departamentit të Shkencave Juridike për vitin akademik 2015-2016 janë angazhuar 17 PAE dhe 34 PAK. Në trupën akademike (PAE) ka: një pedagoge me titullin akademik Prof.Asoc.Dr; pesë pedagogë me gradën shkencore Dr; tetë pedagogë në proces doktorature dhe tre pedagogë me MSC.

Programi i studimeve “Master Shkencor në Shkenca Juridike” (sipas profileve përkatëse) ka 5 pedagoge efektive – katër prej të cilëve kanë gradën shkencore Dr dhe; 9 pedagoge me kontratë - nga të cilët katër kanë titujt akademik Prof.Dr/Prof.Asoc dhe pesë kanë gradën shkencore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Personeli akademik i angazhuar në procesin mësimor për programin e studimit Msc (sipas profileve) përkatës zptëron titujt dhe grada shkencore të nevojshme për realizimin e këtyre programve Msc. Stafit akademik efektiv është i angazhuar në rolin e titullarit të lëndëve sipas profileve. Ky staf akademik (PAE) në raport me stafin me kontratë (PAK) realizon një ngarkesë akademike në auditor në masën 60- 70 %, e cila ndër vite akademike (2011-2015) ka qenë e variushme: a)për faktin që jo të gjitha profilet e programit studimore kanë qënë efektive; b) numri i studentëve jo në të gjitha profilet ka qënë i përshtatshëm për angazhimin e stafit; c) lëndët me zgjedhje (katër) për secilin profil kërkojnë një profilizim më të ngushtë të stafit akademik. Nëse do të ishte një strategji më e detajuar në lidhje me hapjen e profileve dhe një prognozë më e mirë për nevojën e tregut (kërkesën e studentëve që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve), atëherë do të kishim një përqindje më të lartë të angazhimit të atafit akademik efektivë (PAE) në mbulimin e procesit në auditor ë(PAE).

Nga takimet e realizuara pranë universitetit dhe nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion gjatë këtyre takimeve, konstatohet një angazhim i stafit efektiv në mbulimin e ngarkesës akademike për gjatë viteve (2011-2016) edhe pse ky angazhim nuk është më shumë se 60-70% e mbulimit të ngarkesës në auditor. Grupi i jashtëm i vlerësimit u konsultua me dokumentacionin me të cilin kishte punuar grupi i punës i ngritur pranë institucionit për vlerësimin e brendshëm për realizimin e raportit të brendshëm të vlerësimit (RVB) dhe dokumentacionin e përditësuar. Nga ky lloj ballafaqimi u konstatuan pak ndryshime në lidhje me të dhënat mbi numrin e stafit akademik (PAE & PAK). Po japim më poshtë, në mënyrë përshkruese, të dhënat që lidhen me numrin e stafit (PAE & PAK) të angazhuar në procesin mësimorë në auditor (Master Shkencor në “Shkenca Juridike”) për vitet akademike (2011-2016).²

- për vitin akademik 2011-2012 janë angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin mësimor në auditor: 3 (tre) PAE dhe 5 (pesë) PAK

² Të dhënat e mësipërme, në lidhje me angazhimin e stafit janë evidentuar nga GVJ gjatë vizitës që realizuam pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore.

- për vitin akademik 2012-2013 janë angazhuar : 7 (shtatë) PAE dhe 6 (gjashtë) PAK.
- për vitin akademik 2013-2014 janë angazhuar : 7 (shtatë) PAE dhe 10 (dhjetë) PAK.
- për vitin akademik 2014-2015 janë angazhuar : 8 (tetë) PAE dhe 7 (shtatë) PAK.
- për vitin akademik 2015-2016 janë angazhuar : 5 (pesë) PAE dhe 9 (nëntë) PAK.

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton që angazhimi i personelit akademik efektiv (në terma sasiorë/numër orësh) më mbulimin e ngarkesës mësimore në auditorë ka qenë mjaft i variushëm ndër vite.

Të dhënat e mësipërme gjenden dhe në Aneksin 1 dhe 2 bashkëngjitur këtij raporti

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton ndryshime në lidhje me të dhënat që lidhen me numrin e stafit akademik në raport me të dhënat që ishin paraqitur në raportin e vlerësimit të brendshëm, pasi në ato të dhëna nuk përfshihej dhe numri i stafit të angazhuar në semestrin e dytë të vitit akademik 2015-2016.

Për shkak të shtrirjes së gjatë të vlerësimit të programeve të studimit për vitet akademike 2011-2016, grupi i vlerësimit të jashtëm do të paraqesë të dhënat e ndara në dy periudha kohore akademike 2011-2015 dhe 2015-2016.

Stafi akademik i departamentit të Shkencave Juridike i angazhuar në programin mësimor Msc në "Shkenca Juridike" përbëhet nga:

I.

- për vitet akademike 2011-2015 stafi efektiv (PAE) përbëhet nga: 2 (dy) pedagogë me tituj (Prof.Asoc); 4 (katër) pedagogë me gradën shkencore dhe 4 personal administrativ.
- për vitet akademike 2011-2015 stafi me kontratë (PAK) përbëhet nga: 5 (pesë) pedagogë me tituj dhe 5 (pesë) pedagogë me gradën shkencore dhe asnjë personel administrativ.

Raporti ndërmjet pedagogëve efektiv dhe atyre të angazhuar me kontratë PAE/PAK është: 2/3 për pedagogët me tituj akademik dhe; 4/5 për pedagogët me gradën shkencore.

Raporti ndërmjet pedagogeve femra të angazhuar në këtë program dhe pedagogëve meshkuj është: 3/4 për pedagogët me tituj dhe 4/6 për pedagogët me gradë shkencore.

II.

- për vitin akademik 2015-2016 stafi efektiv (PAE) përbëhet nga: 4 (katër) pedagogë me gradën shkencore; 1 (një) pedagogë me Msc/ në proces doktorature dhe dy personel administrativ.
- për vitin akademik 2015-2016 stafi me kontratë përbëhet nga: 4 (katër) pedagogë me tituj dhe 5 (pesë) pedagogë me gradë shkencore;

Raporti ndërmjet pedagogëve efektiv dhe atyre të angazhuar me kontratë (PAE/PAK) është: 0/4 për pedagogët me tituj akademik dhe; 4/5 për pedagogët me gradë shkencore.

Raporti ndërmjet pedagogeve femra të angazhuar në këtë program dhe pedagogëve meshkuj është: 3/1 për pedagogët me tituj dhe 3/6 për pedagogët me gradë shkencore.

Grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh me kontratat individuale të punës të stafit akademik (PAE & PAK) dhe një nga elementët e kontratës së punës lidhej dhe me të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit (përkatesisht në nenet 6-10).

Handwritten signatures and initials in blue ink.

**Të dhënat e mësipërme gjenden dhe në Aneksin 3 dhe 4 bashkëngjitur këtij raporti.*

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrative angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● Personeli akademik dhe administrativ është i përfshirë në realizimin e programeve të studimit dhe ndërmjet personelit akademik dhe administrative ka një frymë bashkëpunimi dhe barazpeshim të përgjegjesive të nevojshme për realizim e procesit mesimor dhe shkencor. Anëtarët e stafit akademik dhe administrative janë në funksion të procesit mësimdhënës dhe nxënës dhe shpërndajnë informacionin ndërmjet tyre. Në cdo njësi dhe seksion përbërës të institucionit/departamentit ka njerëz të përkushtuar, me eksperiencë në fushën që ata kontribuojnë si dhe ekspert në disiplinat përkatëse ku janë angazhuar.
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ● Personeli akademik është i përfshirë jo vetëm në hartimin e plan-programit/syllabus të lëndës që zhvillon, por edhe në harmonizimin e përmbajtjes së një lënde përkatëse me grupin e lëndëve që janë pjesë e së njëjtimit trung. Rekrutimi i stafit është më shumë në drejtim të përmbajtjes së lëndës dhe specializimit e kualifikimit të posacem që ajo ofron. ● Departamenti ka mbajtur/ruajtur një memorie institucionale në lidhje me angazhimin e stafit akademik, pasi shumë nga anëtarët e këtij stafi kanë vite që gjenden të punësuar pranë institucionit/departamentit. Ka një alternim brezash dhe eksperiencash që ndihet në mënyrën e hartimit të akteve administrative nga njësitë përkatëse. Disa nga anëtarët e stafit akademik kanë një angazhim dhjetëvjeçar pranë këtij departamenti, një kontribut që reflekton jo vetëm vazhdimësi por edhe përpjekje konstante për të thelluar dhe rritur kapacitetin profesional të disiplinës që japin dhe njohurive që transmetojnë. ● Në rekrutimin e stafit të ri, në kontratën e punës është e përcaktuar ngarkesa mësimore vjetore si dhe angazhimet e tjera në funksion të veprimtarive kërkimore-shkencore dhe administrative të departamentit.

Handwritten signatures and initials in blue ink.

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;
Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;
Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

- Universiteti ka një procedurë publike të përrthithjes së kërkesës së atyre që shprehin dëshirën të angazhohen në procesin mësimor. Në hapat e përzgjedhjes në një fazë të dytë institucioni përgjithësisht ndjek dhe preferon procedurën e ruajtjes së vijimësisë në marrëdhënie kontraktore me personelin që edhe më parë mund të ketë kontribuar pranë departamentit.
- Ka një kriter që lidhet sa me meritën aq dhe me besueshmërinë. Ky element përzgjedhës vihet re nga të dhënat ndër vite të angazhimit të stafit me institucionin. Gjithnjë prurjet e reja gjenden të shoqëruara me emra të stafit që kanë bashkëpunuar më parë dhe janë rikthyer sërisht si bashkëpunorë.
- Personeli akademik (PAE) nga të dhënat dhe dokumentacioni përkatës realizon në masën 60- 70% të ngarkesës në auditor të programeve të studimit (sipas profileve përkatëse). Realizimi dhe përmbushja e këtij kriteri është mjaft e variushme ndër vite edhe për shkak të ndryshimit të raportit të PAE me PAK.

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;
Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;
Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;
Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;
Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

- Drejtuesi i programit ka gradën shkencore (PHD) të fituar pranë universitetit “La Sapienza” në Romë.
- Titullarët e lëndëve kanë titujt dhe gradat e duhura si kërkesa të ligjit dhe si nevojë akademike për realizimin e programit mësimorë.
- Të gjithë titullarët e lëndëve kanë së paku gradën shkencore (Dr) dhe në fushën dhe disiplinën ku japin mësim kanë përvojën e duhur akademike.
- Të gjithë autoritetet drejtuese të institucionit kanë tituj akademik dhe në njësitë që ata drejtojnë janë emra të njohur dhe me kontribute reale në fushën e drejtësisë.
- Pranë departamentit të Shkencave Juridike ka një personel akademik që mban titujt dhe gradën e duhur për të drejtuar/udhëhequr punimet shkencore/tema masteri të studentëve.
- *Praktika profesionale nuk është konceptuar si një lëndë më vete.*

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i

Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;

Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;

Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.

Pedagogu udhëheqës ka të paktën gradën shkencore dhe numri i atyre që udhëheqin temat e masterit të studentëve është brenda limitit të standardit. Gjatë bisedës me pedagogët kuptuam devotshmërinë e tyre për të bashkëpunuar me studentët në procesin e kërkimit shkencor, në draftimin dhe përgatitjen e tezave të tyre, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme dhe periodike, jo vetëm gjatë procesit por edhe pas përfundimit të studimeve.

Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.

Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.

Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.

Pedagogët udhëheqës kanë kualifikimin e duhur akademik dhe shkencor për të drejtuar punimet shkencore të studentëve.

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.

Nga vizitat pranë ambjenteve të universitetit dhe nga takimet që realizuam me drejtuesit përkatës, rezultoi që autoritetet drejtuese të universitetit dhe drejtuesit e njësisë bazë/departamentit të Shkencave Juridike kanë përkushtimin e duhur për realizimin e procesit mësimor dhe ofrimit për studentët të mjediseve të përshtatshme.

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Handwritten signatures and initials in blue ink.

<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës (kontrata individuale e punës/aneks kontrata), konstatohet që ngarkesa mësimore e stafit akademik është e normuar në orë pune mësimore për semestër/vit akademik; organizim konferencash; kordinim praktike; ndjekje dhe udhëheqje e studentëve për zhvillimin e diplomës etj.</p>
--	--

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti disponon një bazë të dhënash për personelin akademik (PAE & PAK) të angazhuar sipas profileve përkatëse. • Zyra e Burimeve Njerëzore disponon listën e personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për njësinë përkatëse si dhe atë në aspektin institucional. • Universiteti/departamenti aplikon procedurën publike të shpalljes së nevojës me staf akademik.
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Vlerësohet që mbajtja e të dhënave në lidhje me stafin akademik (PAE & PAK); administrativ dhe ndihmës mësimor-shkencor është e hollësishme dhe për cdo angazhim të personelit në kuadër të departamentit ka një historik të marrëdhënieve kontraktore. Pranë zyrës përkëtesë (Zyra e Burimeve Njerëzore) gjënden të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin; angazhimin akademik (orë mësimore në auditor); angazhimin ndër vite; titujt/gradat për çdo anëtar të stafit akademik (PAE & PAK) të përfshirë në procesin mësimor në këtë program studimi (Msc në "Shkenca Juridike").

Standartet e mësipërme përmbushen plotësisht.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Mjediset për programin e studimit në Universitetin 'AU' rezultuan të jenë mjaft të përshtatshme për të realizuar procesin mësimor. Gjatë vizitës në universitet pamë sallat e leksioneve, klasat ku zhvillohen seminarët, një auditorium mjaft i madh ku janë zhvilluar dhe mund të zhvillohen edhe në të ardhmen aktivitete të rëndësishme shkencore dhe me profil të gjerë mediatik. Në katin përdhësë ishte vensodur **Biblioteka** e cila mjaft mirë mund të përdoret jo vetëm për të shfrytëzuar literaturë në trajtën e materialeve të printuara (*hard copy*) por edhe në versionin elektronik me bibliotekën online '*Questia*'. Në dispozicion të studentëve në ambientin e Bibliotekës ishte konceptuar edhe një kënd studimor komod në mënyrë që literarura të mund të shfrytëzohet edhe në sallë. Biblioteka ishte e pajisur edhe me disa kompjutera të lidhur me internet, nga ku studentët mund të aksesojnë emailin, printojnë materiale apo realizojnë kërkime shkencore. Lidhur me ambientin ku është përshtatur biblioteka, konstatuam se ambienti për shkak të vendodhjes në katin përdhësë kishte lagështirë, ndaj rekomandojmë që në të ardhmen ky ambient të përshtatet

122

[Signature]

për kushtet e leximit dhe të ruajtjes së librave në kushte lageshtie optimale. Në ambientet e universitetit nuk mungonte as një vend i dedikuar për printime, fotokopje, etj.

Vizituam gjithashtu edhe mjediset për stafin (një nga këto ambiente ju vu edhe në dispozicion Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për të zhvilluar takimet e programuar në universitet) - ato rezultuan mjaft komode dhe të përshtatshme për stafin (Dekanin, pedagogët/personelin akademik), për Qendrën Kërkimore e Shkencore si dhe për stafin administrativ. Një vizitë e vecantë u realizua në sekretarinë mësimore e cila ndodhej në katin e parë. Kushtet e punës të sekretarisë mësimore rezultuan përgjithësisht të përshtatshme, me përjashtim të një defekti i cili mund të riparohet mjaft lehtë në të ardhmen që ishte ndricimi i pakët. Duke qënë se sekretaria mësimore përpilon të gjithë dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor dhe provimet është e nevojshme që ndricimi të jetë në parametra optimale.

Lidhur me laboratorët rezultoi se në disiplinën e së drejtës nuk ka ndonjë kërkesë specifike për to, por bazuar edhe në eksperiencën e universiteteve të tjera do të rekomandonim që një nga sallat e vogla të seminareve të mund të organizohet në formën e një salle gjyqi, ku të mund të improvizoheshin seanca gjyqësore, apo të realizoheshin 'mocket trial' gjyqe imituese. Një klinikë/laboratot i tillë do t'i shërbente jo vetëm programit të ciklit të dytë të studimeve Master, por gjithashtu edhe studentëve të nivelit bachelor, dhe mund të koordinohet apo implementohet lehtësisht në kuadrin e praktikës profesionale si një komponent përbërës i saj.

Në tërësi, lidhur me mjediset e universitetit, të dhënat sasiore të RVB u verifikuan se përputheshin me kushtet e mjedisëve, gjatë vizitës në vend.

Zyra/Këndi i Informacionit gjithashtu është e vendosur në katin e parë dhe zë një hapësirë të konsiderueshme të tij; këndi i informacionit për studentët si dhe për kandidatët potencialë që interesohen të studiojnë në këtë universitet është jo vetëm i madh në sipërfaqe por edhe mjaft mirë i areduar e i furnizuar me broshura të shumta informative, pasi është pjesa më e përshtatshme për të realizuar marketingun e programeve.

Infrastruktura e universitetit është e përshtatshme për të zhvilluar programet e studimit master për të cilat kërkohet akreditim, duke filluar që nga vendodhja në qendër të qytetit, e duke vijuar me sallat, pajisjet, mobilimin, etj.

Teknologjia e Informacionit është bashëkohore. Në sallat e leksioneve janë instaluar projektorë që e bëjnë mjaft më të thjeshtë procesin e mësimdhënies dhe diskutimeve/debateve.

Shërbime të tjera për Studentët - Në katin e parë të godinës gjendet edhe një kafene mjaft komode e cila natyrshëm mund të përdoret nga studentët për takimet e tyre, diskutime të shkurtra, mund të shërbejë në disa pjesë edhe si hapësirë leximi. Aty ofrohen edhe shërbime 'snaks' pra gatime/ushqime të shpejta që mund t'u vijnë në ndihmë si studentëve ashtu edhe stafit.

Rezidencat - Gjatë vizitës në universitet u informuam se 'AU' ka pasur operative një godinë fjetjeje (konvikt) për studentët që vijnë nga rrethet, por që nuk është më aktive.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	

Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;

Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;

Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.

Universiteti ka vendodhje të përhershme, tashmë për një periudhë kohore rreth 10 vjecare, ku zhvillohet kryesisht veprimtaria mësimore, kërkimi shkencor, organizimi i takimeve profesionale si dhe pjesa kryesore e veprimtarisë mbështetëse administrative. Në të njëjtën godinë realizohet gjithashtu edhe informimi i studentëve që kërkojnë të jenë pjesë e programeve Master. Veprimtaria administrative në rang Fakulteti realizohet në një godinë tjetër, edhe kjo funksionale për rreth 10 vjet, që siguron koordinim dhe menaxhim efikas për arritjen e standardeve të politikës arsimore të institucionit.

Sipas materialeve të vëna në dispozicion gjatë vizitës në institucion, biblioteka online 'Questia' disponon rreth:

- Libra (4 613)
- Artikuj shkencorë (74 645)
- Revista (135 566)
- Gazeta (916 244)
- Enciklopedi (2 562)

Universiteti nuk ofron ambjente specifike për zhvillimin e praktikës profesionale. *Sic u përmend edhe më sipër, komponenti i Praktikës Profesionale nuk është parashikuar si jetë pjesë integrale dhe formale e kurrikulës së programeve Master, megjithatë trupa pedagogjike e këtyre programeve ka arritur të drejtojë dhe mbikqyrë studentët në veprimtari profesionale dhe kërkimi shkencor, alternative me praktikën profesionale, në funksion të rritjes së cilësisë të transmetimit të njohurive praktike tek ta, si takime me ekspertë, konferenca shkencore ndërkombëtare në partneritet me institucione të huaja të arsimit të lartë me një eksperiencë të gjatë, botim esesh, forume diskutimesh, etj.*

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës

Universiteti ka një Bibliotekë, në një hapësirë të konsiderueshme që gjendet në katin përdhësë të godinës. Biblioteka ofron akses mjaft të mire fizik por edhe mundësi leximi në sallë. Nga vizita në institucion, rezultoi se ka një person të dedikuar me kohë të plotë që është në dispozicion të lexuesve, për orientim të studentëve për kërkimin e teksteve, për vënien në dispozicion të listës së botimeve/teksteve dhe kërkimin e literaturës në fushat specifike të së drejtës. Biblioteka ofron edhe shërbimin e internetit që studentët mund ta shfrytëzojnë për kërkime të specializuara, dhe qëndron e hapur të gjitha ditët e javës, orari 08: 00-16: 00, ditën e shtunë orari 08: 00-12: 00, kurse dita e diel është pushim. Duke qënë se studentët e programe master në një pjesë të madhe të tyre janë edhe të punësuar, do të

në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

rekomandonim që biblioteka të qëndronte e hapur të gjitha ditët e javë deri në orën 20.00 me qëllim që t'u vijë në ndihmë atyre qoftë si ambient studimi, qoftë si ambient kërkimi shkencor.

Biblioteka ofron disa botime periodike si dhe librarinë elektronike '**Questia**' (<https://www.questia.com/member-login>), të cilat përmbanin libra dhe revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, si dhe projekteve kërkimore shkencore për përgatitjen e tezës së studentëve.

Nga vizita në universitet dhe takimet me pedagogët dhe stafin mbështetës/administrativ na u komunikua se ka filluar të zbatohet një praktikë ku departamentet hartojnë lista me kërkesa për libra/botime të reja, së bashku me kostot përkatëse. Këto kërkesa kalojnë më pas tek Bordi Administrativ për t'u diskutuar nga pikëpamja financiare dhe për t'u realizuar.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Universiteti rezultoi se ofronte ambiente të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimeve, kryesisht në trajtën e sallave të leksioneve dhe seminareve, si dhe hapësirave ku mund të zhvillohen edhe debate /diskutime publike që mund të regjistrohen dhe të transmetohen edhe në media.

Lidhur me laboratorët rezultoi se në disiplinën e së drejtës nuk ka ndonjë kërkesë specifike për to, por bazuar edhe në eksperiencën e universiteteve të tjera do të rekomandonim që një nga sallat e vogla të seminareve të mund të organizohet në formën e një salle gjyqi, ku të mund të improvizoheshin seanca gjyqësore, apo të realizoheshin '*mocket trial*' gjyqe imituese. Një klinikë/laborator i tillë do t'i shërbente jo vetëm programit të dytë të studimeve Master, por gjithashtu edhe studentëve të nivelit bachelor, dhe mund të koordinohet apo implementohet lehtësisht në kuadrin e praktikës profesionale si një komponent përbërës i saj.

Konkluzionet e vlerësimit:

Universiteti ka vendodhje të përhershme, afatgjatë, tashmë për një periudhë kohore rreth 10 vjecare, ku zhvillohet kryesisht veprimtaria mësimore, kërkimi shkencor, organizimi i takimeve profesionale si dhe pjesa kryesore e veprimtarisë mbështetëse administrative. Në të njëjtën godinë realizohet gjithashtu edhe informimi i studentëve që kërkojnë të jenë pjesë e programeve Master.

Universiteti ka një Bibliotekë të dedikuar shkencave humane, ku përfshihet edhe disiplina e drejtësisë, në një hapësirë të konsiderueshme në godinën ku zhvillohet aktiviteti mësimdhënës i programit të studimit. Biblioteka

ofron akses mjaft të mire fizik por edhe mundësi leximi në sallë. si dhe një person të dedikuar me kohë të plotë që është në dispozicion të lexuesve, Biblioteka ofron shërbimin e internetit që studentët mund ta shfrytëzojnë për kërkime të specializuara, Duke qënë se studentët e programe master në një pjesë të madhe të tyre janë edhe të punësuar, do të rekomandonim që biblioteka të qëndronte e hapur të gjitha ditët e javës, edhe pasditeve (*duke qënë se është funksionale deri në orën 16.00*). Biblioteka ofronte disa botime periodike si dhe librarinë elektronike 'Questia' (<https://ëëë.questia.com/member-login>), të cilat përmbanin libra dhe revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, si dhe projekteve kërkimore shkencore për përgatitjen e tezave të studentëve.

Institucioni rezultoi se ofronte ambiente të përshtatshme për zhvillimin e programit të studimeve, kryesisht në trajtën e sallave të leksioneve dhe seminareve, si dhe hapësirave ku mund të zhvillohen edhe debate /diskutime publike që mund të regjistrohen dhe të transmetohen edhe në media.

Rekomandojmë që një nga sallat e vogla të seminareve të mund të organizohet në formën e një salle gjyqi, ku të mund të improvizohen seanca gjyqësore/gjyqe imituese; kjo do t'i shërbente jo vetëm programit të dytë të studimeve Master, por gjithashtu edhe studentëve të nivelit bachelor, dhe mund të koordinohet apo implementohet lehtësisht në kuadrin e praktikës profesionale si një komponent përbërës i saj.

Standartet e mësipërme përmbushen plotësisht.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Burimet e financimit në programin e kërkuar për akreditim vijnë 100 % nga pagesat e shkollimit të studentëve. Universiteti mban bilance të rregullta lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e programeve të studimit. Për programin e studimit për të cilin kërkohet akreditim, universiteti nuk ka marrë asnjë grant për kërkim dhe nuk ka asnjë të ardhur nga konsulencat apo donacion/sponsorizim. Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti tregtar, të dhënat janë llogaritur si të ardhura për universitetin në tërësi, dhe jo vetëm për programe të caktuara.

Lidhur me treguesin e llogaritjes së **kostos për student**, nuk e konstatojmë të llogaritur në ndonjë dokument specifik, por bazuar në dokumentacionin financiar që na u vu në dispozicion si edhe në të dhënat e RVB për llogaritja e saj është mjaft e mundur duke pjesëtuar shpenzimet totale të programit me numrin e studentëve që kanë frekuentuar programin.

Kapacitetet menaxhuese të universitetit rezultuan efektive si nga bisedat që zhvilluam në institucion ashtu edhe nga dokumentat dhe analizat e paraqitura në RVB; në pasqyrat financiare të vëna në dispozicion rezultonte që më tepër se 80 % e të ardhurave nga tarifat e shkollimit shpenzohet për paga, honorare, kërkim shkencore dhe fond ekselence, pra shkon për studentin.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	

<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Duke u nisur nga të dhënat e RVB dhe nga materiali financiar që na u vu në dispozicion gjatë vizitës tonë në ambientet e universitetit, në lidhje me programin e studimit që kërkohet të akreditohet, rezultojnë që: të ardhurat e institucionit vijnë tërësisht nga tarifat e studimit. Më tepër se 80 % e tyre shpenzohet për paga, honorare, kërkim shkencor dhe fond ekselence. Në pasqyrat financiare të vëna në dispozicion nuk reflektohen grante apo fonde të huaja të përfituara.</p> <p>Fakti që pjesa dërrmuese e shpenzimeve të të ardhurave të krijuara kalon për pagesat e mësimdhënies, kërkim shkencor dhe fond ekselence, përfshirë këtu edhe bibliotekën online 'Questia' tregon një efektivitet të përdorimit të të ardhurave, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe ekspertizes së ofruar në program.</p>
---	---

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Nga RVB në lidhje me pasqyrat financiare të cilat ishin të detajuara sipas zërave (<i>Të ardhura/Shpenzime/Fitimi</i>) për programet e studimit (ndër vite), konstatohet stabilitet dhe vazhdimësi financiare. Nga raportet nuk u konstatua ndonjë mundësi konkrete gjenerimi të ardhurash, përveç tarifave të studimit nga vetë studentët, por nga Zyra e Karrierës na u komunikua që nga studentët e diplomuar përgjatë viteve në 'AU' të mund kërkohet mbështetje financiare në trajtën e donacioneve apo hapësira të tjera internshipi/punësimi, sic aplikohet edhe në IAL jashtë vendit, të cilat janë të konsoliduara dhe me traditë akademike.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:
Të ardhurat e universitetit vijnë tërësisht nga tarifat e studimit. Më tepër se 80 % e tyre shpenzohet për paga, honorare, kërkim shkencor dhe fond ekselence. Fakti që pjesa dërrmuese e shpenzimeve të të ardhurave të krijuara kalon për pagesat e mësimdhënies, kërkim shkencor dhe fond ekselence, përfshirë këtu edhe bibliotekën online 'Questia' tregon një efektivitet të përdorimit të të ardhurave, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe ekspertizes së ofruar në program.

Pasqyrat financiare ishin të detajuara sipas zërave (*Të ardhura/Shpenzime/Fitimi*); nga analizimi i tyre ndër vite u konstatua stabilitet dhe vazhdimësi financiare. Nga raportet nuk u konstatua ndonjë mundësi konkrete gjenerimi të ardhurash, përveç tarifave të studimit nga vetë studentët, por për studentët e diplomuar në të ardhmen mund të kërkohet mbështetje financiare në trajtën e donacioneve apo hapësira të tjera internshipi/punësimi.

Standartet e mësipërme përmbushen plotësisht.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Handwritten marks and signatures at the bottom right of the page.

Zyra e Sigurimit të Brendshmën të Cilësisë (ZSBC) është e ngritur në rang institucional në bazë të statutit të universitetit. Kjo zyrë siguron drejtimin, këshillimin dhe mbështetjen për hartimin dhe zbatimin e procedurave të brendshme të sigurimit të cilësisë. Rregullat e vlerësimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në udhëzimet përkatëse, të cilat miratohen nga Senati.

Sipas Statutit të Universitetit, Zyra e Sigurimit të Brendshmën të Cilësisë (ZSBC) është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit dhe raporton periodikisht në lidhje me detyrat/veprimtarinë e kryer.

Zyra e Sigurimit të Brendshmën të Cilësisë (ZSBC) harton një raport vjetor, në të cilin përfshihen informacionet/vlerësimet në lidhje me procesin mësimdhënies dhe nxënies. Kjo zyrë jep rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e procesit mësimor. Ky raport vjetor i prezantohet Rektorit dhe më pas ky autoritet drejtues e paraqet pranë Senatit Akademik.

Zyra e Sigurimit të Brendshmën të Cilësisë (ZSBC) bashkepunon dhe me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës. ZZHK, mbikqyr dhe orienton përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës.

Sipas Statutit të Universitetit, Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulës ka detyrimin e paraqitjes së mendimeve dhe rekomandimeve me shkrim pranë Senatit dhe Këshillave të Fakultetit, në lidhje me përmbajtjen e kurrikulave që diskutohen në këto organe kolegiale.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Zyra e Sigurimit të Brendshmën të Cilësisë (ZSBC) drejtohet nga Elona Mehmeti dhe Sidita Coniku (anëtare) dhe Leudita Docaj (anëtare). Kjo zyrë ka organizuar anketime tek 90% e totalit të studentëve. Të gjitha të dhënat janë përpunuar dhe janë vënë në dispozicion të departamentit të Shkencave Juridike. Rezultatet e pyetsorëve janë diskutuar në organet kolegiale vendimmarrëse si Këshilli i Fakultetit dhe Senati Akademik. Këto organe rest pas rasti kanë marrë vendimet e duhura për përmirësimin e atyre aspekteve të procesit mësimor që studentët kanë evidentuar. Pedagogët e programit të studimit Msc “Në Shkenca Juridike” janë njohur me të dhënat e pyetsorëve si dhe me komentet që studentët kanë bërë për secilin pedaogë. Nga takimi që grupi i vlerësimit të jashtëm pati me stafin akademik (PAE & PAK), mësoi se disa nga pedagogët kishin reflektuar mbi ato komente të studentëve që ata i konsideronin të arsyeshme.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	

Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;

Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.

Të tërthorta:

- a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;
- b. Sondazhe të vlerësimit të mesimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;
- c. Pyetje konceptuale;
- d. Intervista;
- e. Etj.

Të drejtpërdrejta:

- a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);
- b. Dëgjime në auditor;
- c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;
- d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;
- e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;
- h. Etj.

Departamenti i Shkencave Juridike përdor anketimet tek studentët si një instrument për vlerësimin e programeve të studimit.

Këto anketime në formën e formularëve për vlerësimin e stafit akademik dhe administrative lidhen me :

- metodat e mesimdhënies që përdor pedagogu.
- integrimin e kërkimit shkencor me mesimdhënien.
- qartësia e gjuhës së pedagogut.
- sjellja etika e tij në auditor dhe jashtë auditorit.

Departamenti i Shkencave Juridike përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e stafit akademik dhe administrativ nëpërmjet anketimeve që zhvillohen çdo semestër tek studentët.

Nuk rezultojnë që universiteti të përdor metoda të tërthorta për vlerësimin e stafit akademik dhe administrativ.

Departamenti i Shkencave Juridike nuk përdor instrumentin e vlerësimit të stafit nga stafi "peer to peer".

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior

e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike përdor formularë vlerësimi për pedagogët dhe stafin administrative tek studentët (ky formular gjëndet dhe online).</p> <p>Institucioni publikon në faqen e tij raportet e vlerësimit të brendshëm (RVB).</p> <p><i>Nuk ka të dhëna të tjera në lidhje me këtë standart.</i></p>
Standarti II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Drejtuësi i Departamentit të Shkencave Juridike (në bazë të nenit 15 të rregullores së fakultetit) bën analiza të punës mësimore shkencore të departamentit dhe propozon masa për përmirësimin e mëtejshëm të tyre. Nëpërmjet analizës vjetore të hartuara nga drejtuesi i departamentit/programit të studimit evidentohen elementet që mund të jenë përmirësuar në drejtim të procesit mësimor apo ato që mund të përmirësohen.</p> <p>Në nivel institucional hartohet një raport vjetor mbi ecurinë e institucionit dhe standartet që mund të ndikojnë në përmirësimin e programeve të studimit. Vendimet për përcaktimin e standarteve vendosen nga organet kolegjale dhe titullari i institucionit (Rektori).</p>
Standarti VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Universiteti/departamenti aplikon një procedurë të unifikuar në lidhje me matjen e zbatimit të standarteve për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Institucioni e ka të publikuar strategjinë që lidhet me këtë aspekt të procesit akademik.</p> <p>Departamenti nuk aplikon ndonjë standart të vetin në lidhje me përmirësimin cilësorë të procesit akademik.</p> <p>Nuk zezulton që departamenti të ketë një strategji të mirëpërcaktuar për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies si dhe nuk ka një akt nënligjor ku të përcaktohen qartë hapat dhe procedurat që do të zbatoj Departamenti i Drejtësisë në aspektin e rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies, përveç atyre në nivel institucional.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Fakulteti i Shkencave Shoqërore/Departamenti i Shkencave Juridike aplikon në mënyrë periodike (në cdo semestër) anketime tek studentët për vlerësimin e programeve të studimit. Me anë të këtyre anketimeve mbliidhen të dhëna në lidhje me: metodat e mesimdhënies që përdor pedagogu; integrimin e kërkimit shkencor me mesimdhënien; qartësia e gjuhës së pedagogut; sjellja etika e tij në auditor dhe jashtë auditorit.

Në bazë të Rregullores së Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Drejtuesi i Departamentit të Shkencave Juridike (neni 15) bën analiza vjetore mbi procesin mësimor-shkencorë të departamentit dhe propozon masat për përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi.

Departamenti nuk aplikon ndonjë standart të vetin në lidhje me përmirësimin cilësor të procesit akademik përveç atij që është në rang institucional. Departamenti i Shkencave Juridike nuk përdor instrumentin e vlerësimit të stafit nga stafi "peer to peer".

Standartet e mësipërme përmbushen pjesërisht.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit të ciklit të dytë Msc "Në Shkencat Juridike" ofron njohuri në fushën e të drejtës private dhe publike. Misioni/qëllimi i programit të studimeve (sipas profileve) synon të a) japë njohuri specifike në fushat përkatëse sipas profileve- nëpërmjet ofrimit të grupit të lëndëve me zgjedhje të shtrira përgjatë dy viteve të studimit. b) ofrojë trajnime për kërkimin shkencor nëpërmjet ofrimit të lëndëve që lidhen me instrumentat dhe teknikat e kërkimit (lënda " Metodat e kërkimit shkencor")

Programi i studimit Msc në "Shkenca Juridike" është i organizuar në pesë profile:

- E drejtë publike dhe administrative
- E drejtë private
- E drejta penale
- E drejtë ndërkombëtare dhe BE
- Marrëdhëniet ndërkombëtare

Pranë Departamenti të Shkencave Juridike aktualisht janë aktive vetëm dy prej profileve të licensuara:

- E drejtë penale
- E drejtë private

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhënat bazë të programit studimor lidhen me: a) përcaktimin e objektivave të programit; b) organizimin e tij sipas viteve/semestrave; c) përcaktimin e lëndëve/moduleve për cdo semester e shprehur në ETCS; d) cdo program lënde ka të përcaktuar numrin e krediteve sipas sistemit ECTS/ orë mësimore në auditor (leksione, seminare, punë praktike).

1 (një) vit akademik ka – 30 javë në auditor

1 (një) semestër ka – 15 javë në auditor

1 (një) vit akademik ka - 2 (dy) semestra me orë në auditor

1 (një) ECTS ka- 25 orë mësimore pune të studentit

25 orët mësimore janë ndarë në – 10 orë në auditor dhe 15 orë jashtë auditorit

1 (një) ECTS përbëhet nga – 10 orë në auditore/15 orë punë e pavarur

Në planin studimor/ mësimore sipas profileve jepet ndarja e krediteve (ECTS) sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë:

- | | |
|------------------------------|---|
| ▪ Për leksionet | 660 orë në auditor dhe 765 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret | 270 orë në auditor dhe 630 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Laboratorët | 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën lëndore | 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Provimi përfundimtar | 100 orë në auditor dhe 650 orë punë e pavarur e studentit |

Lëndët janë të grupuara në: lëndë të formimit bazë (6 kredite); lëndë në disiplinën e formimit karakterizues (60 kredite); lëndë me zgjedhje (6 kredite); lëndë formuese/metodike (6 kredite) dhe punimi i diplomës 30 kredite.

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se nuk programohet/realizohet asnjë orë mësimore auditor për praktikën profesionale të studentit dhe asnjë orë punë e pavarur e studentit.

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk konstatoi ndryshime ndërmjet planeve mësimore të licensuara dhe atyre të realizuara.

*Nuk ka asnjë ndryshim në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara. Të dhënat përkatës gjënden dhe në Aneksin 6 bashkëngjitur këtij raporti.
Cdo modul/lëndë përmban: titullin e lëndës; titullarin/grupin e pedagogëve; numrin e krediteve; kohën e realizimit të modulit; llojin e lëndës (lëndë formimi bazë apo formimit karakterizues); përshkrimin e lëndës; aftësimin e studentëve përgjatë zhvillimit të lëndës; temat që do të zhvillohen dhe numrin përkatës të orëve; temat për orët praktike dhe numrin e orëve; metodologjinë e mësimdhënies; detyrimet e studentit; formën e vlerësimit dhe komponentët përbërës të vlerësimit; literaturën e detyrueshme dhe plotësuese.

*Planet mësimore të programeve të studimit Msc “Në Shkencat Juridike” (në profilet: E Drejte Penale dhe E Drejtë Private) të lidhura me personelin akademik përkatës (si të vetmet profile aktive), gjënden dhe në Aneksin 7 bashkëngjitur këtij raporti.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve	Programi i studimit Msc “Në Shkencat Juridike” (sipas profileve përkatëse) është i organizuar në module dhe vlerësuar në kredite sipas sistemit (ECTS); 1 kredit është vlerësuar me 10 orë në auditorë dhe 15 orë pune të pavarur të studentit; ora në auditorë është e ndarë në

<p>(ECTS); Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>orë leksioni dhe seminari në raportin: 2/1 dhe 3/2. Cdo vit akademik ka 60 kredite</p>
--	--

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;

Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;

Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;

Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Qëllimi i programit të studimit Msc “Në Shkenca Juridike” (sipas profileve përkatëse) është: a) pajisja e studentëve me njohuritë specifike në fushat më kryesore të së drejtës; b) aftësimi për veprimtari kërkimore-shkencore; c) përdorimit efikas të teknologjisë së informacionit.

GVJ vlerëson pozitivisht përmbajtjen e plan-programeve të lëndëve që ofrohen në këto programe studimore (sipas profileve), me anë të të cilave synohet zgjerimi i njohurive të fituara në ciklin e parë të studimeve.

GVJ konstaton që nga grupi i lëndëve bazë, të cilat zënë rreth 70% të programit të studimit/kurrikulës (sipas profileve), 65% e këtyre lëndëve i përket fushës së të drejtës private dhe 35% fushës së të drejtës penale.

Ka një raport të zhdrejtë në lidhje me peshën që zënë lëndët e detyrueshme sipas dy fushave të së drejtës (publike dhe private), fusha në të cilat orfohen dhe janë aktive dy nga pesë profilet e licensuara të programit të studimeve Msc “Në Shkenca Juridike”.

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshatje me nivelin e studimeve.

<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të</p>	<p>Metoda e vlerësimit përbëhet nga komponente që</p>
--	---

<p>programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>lidhen me aktivizimin e studentëve përgjatë orës që zhvillohet në auditor (10-20%); kontrollit të detyrave të pavarura (10-20%); provim i pjesshëm (10-20%) dhe provimit përfundimtarë (50-70%).</p> <p><i>Në asnjë nga modulet nuk zhvillohen orë në laboratore apo në mjedise të tjera jashtë auditorit.</i></p>
---	---

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavejeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit Msc “Në Shkenca Juridike” është bazuar në përvojën brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Ky program përmban të gjitha elementet e nevojshme që do të mundësonin transferimin e krediteve të fituara të studentëve pranë këtyre programeve në një nga universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit.</p>
--	--

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Msc “Në Shkenca Juridike” (sipas profileve) ofron njohuri në fushën e të drejtës private dhe publike.</p> <p>Misioni/qëllimi i programit të studimeve (sipas profileve) synon të a) japë njohuri specifike në fushat përkatëse sipas profileve- nëpërmjet ofrimit të grupit të lëndëve me zgjedhje të shtrira përgjatë dy viteve të studimit. b) ofrojë trajnime për kërkimin shkencor nëpërmjet ofrimit të lëndëve që lidhen me instrumentat dhe teknikat e kërkimit lënda “Metodat e kërkimit shkencor”</p>
---	--

Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.</p> <p>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>
---	---

huaj.	
-------	--

Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;
- kërkesat e punëdhënësve;
- një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.

Departamenti i Shkencave Juridike, pranë të cilit është i përfshirë programi i studimit Msc, nuk ka kryer, hartuar një strategji konkrete për: mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar.

Departamenti i Shkencave Juridike nuk ka një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këta programe studimi.

Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;

Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Programi i studimit Msc në "Shkencat Juridike" sipas profileve përkatëse synon të ruaj traditën dhe vlerat tona kombëtare.

Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;

Programi i studimit Msc "Në shkencat Juridike" (sipas profileve) është i organizuar në dy vite akademike; me 120 kredite (ECTS) gjithsej (60 kredite për cdo vit akademik). Tema e diplomës është 30 kredite (ECTS). Nuk ka të përfshirë në numrin total të krediteve (120) kredite për praktikën profesionale/projekt kërkimor.

Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.

Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.

Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite

Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.

akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	
--	--

Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.

Studentëve iu ofrohet informacion në lidhje me programin e studimit që në fillim të procesit mësimor. Të gjitha plan-programet e lëndëve janë në dispozicion të studentëve.

Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;
Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.

Për tezën e diplomës janë planifikuar 30 kredite gjithsej dhe në këtë numër kreditesh nuk janë planifikuar orë pune në auditor dhe jashtë auditorit për zhvillimin e praktikës/projektit kërkimor. Nuk ka një “Paketë Diplomimi” apo një model dosje me formularë apo rregullore specifike për realizimin e projektit kërkimor dhe tezës finale/temës së masterit.

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit Msc “Në Shkencat Juridike” është bazuar në përvojën akademike të stafit brenda dhe jashtë vendit. Ky program përmban të gjitha elementet e nevojshme që do të mundësonin transferimin mundshëm të krediteve të fituara nga ana e studentëve pranë një nga universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit. Programi i studimit Msc “Në shkencat Juridike” (sipas profileve) është e organizuar në dy vite akademik me 120 kredite (ECTS) gjithsej (60 kredite për cdo vit akademik). Tema e diplomës është 30 kredite (ECTS). Nuk ka të përfshirë në numrin total të krediteve (120) kredite për praktikën profesionale/projektin kërkimor.

Standartet e mësipërme përmbushen pjesërisht, pasi një nga standartet që nuk plotësohet plotësisht është (II.8.2) ai që lidhet me plan diplomimin e studentit apo Paketën e Diplomimit dhe kryesisht Paketën e Praktikës.

Në këto dy dosje (që duhet të jenë të miratuara nga autoritetet përkatëse) duhet të përfshihen të gjitha informacionet dhe formularët e nevojshëm që plotësohen nga ana e studentit dhe udhëheqësit përpara realizimit të mbrojtjes së tezës dhe përfundimit të praktikës. Parashikimi në rregulloren e programit të studimit Msc (neni 31,32,33,34), lidhen vetëm me të drejtën e diplomimit. Ky rregullim është i pamjaftueshëm, pasi në të nuk jepen rregullime specifike të nevojshme në lidhje me realizimin e praktikës/projektit kërkimorë si komponent akademik i lidhur me diplomimin/tezën finale. Praktika/ projekti kërkimor duhet të konsiderohet si një modul me vete dhe të vlerësohet si të gjitha modulet e tjera si dhe të parashikohen rregulla që lidhen me rastet kur nuk përmbushen kërkesat që lidhen me këtë modul.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference:

Kontrolli i njohurive të studentëve bazohet në tre komponentë; vlerësim i seminareve, testim i ndërmjetëm dhe testimin përfundimtar. Këto komponentë duke u alternuar plotësojnë tablonë e vlerësimit dhe bëjnë atë më objektive dhe reale.

Orari mësimor ka rezultuar i shpallur për studentët në ambientet e IAL dhe nëpërmjet komunikimit elektronik. Nga monitorimi i faqes së internetit të IAL 'AU', nuk rezulton që orari i studimeve të jetë ofruar edhe online, ndaj në të ardhmen rekomandojmë që faqja e internetit të përditësohet edhe me orarin e studimeve për të gjitha ciklet dhe profilet e studimeve, sidomos të atyre Master pasi studentët përgjithësisht janë në marrëdhënie pune dhe mund ta aksesojnë më lehtë. Orari është hartuar në mënyrë të balancuar, që studenti të ketë mundësi edhe të ndjekë leksionet/seminaret/debatet, edhe të përgatitet individualisht

Sallat e leksioneve përveç projektorëve, ofronin edhe një akustikë mjaft të përshtatshme për mësimdhënien pasi zëri/e folura arrinte të mbulonte të gjithë sallën me kapacitet të plotë. Gjithashtu, sallat e leksioneve dhe të seminareve ishin organizuar në mënyrë komode dhe të përshtatshme për t'i krijuar nga njëra anë pedagogut një pozicion drejtues përgjatë procesit si dhe fleksibilitet për të lëvizur nëpër sallë kur kërkohet të ndërveprojë me studentët, dhe për më tepër për të krijuar edhe një ambient komod për studentin qoftë nga pikëpamja akustike, edhe nga pikëpamja fizike (*banka/tavolina*).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Për vlerësimin e procesit mësimor dhe realizimit të komponentëve të tij, grupi e vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Msc "Në Shkencat Juridike" realizoi takime me stafin akademik (PAE & PAK) dhe studentë. Nga të dhënat e RVB rezulton se 'Albanian University' në programin e masterit për të cilin kërkohet akreditim, e ka fokusuar kryesisht procesin e mësimdhënies në organizimin e **leksioneve dhe seminareve**. Stafin akademik realizon përgjatë procesit mësimor debate, diskutime dhe forumet ku diskutohen çështjet me interes më të madh, nën drejtimin e pedagogëve përgjegjës. Bazuar edhe tek Misioni dhe vlerat e proklamuar nga Albanian University, ky institucion ka në fokus *'zhvillimin dhe zgjerimin e kufijve të njohjes përmes arsimit më të mirë, rritjes intelektuale, sociale e kulturore të studentëve, duke kontribuar në dobi të komunitetit me aspiratën e një mjedisi intelektual që nxit mendimin kritik, krijues, me vlera, parime dhe etikë akademike institucionale'* gjë që realizohet gjatë **debateve** në orët e seminareve, duke përbërur gjykime dhe interpretime të ndryshme të **etikës akademike**, duke referuar autorë, rryma dhe qasje të ndryshme ligjore, bazuar mbi botimet e tyre apo edhe artikujt që autorët i kanë dedikuar këtyre çështjeve specifike. Mësimdhënia zhvillohet në vite akademike. Studimet në këto programe shtrihen sipas semestrave; viti akademik ka 2 semestra dhe një semestër ka 15 javë mësimore. Ndërkohë në program 6 javë i dedikohen përgatitjes dhe dhënies së provimeve. Në një javë mësimore studentët kanë realizuar 20 orë mësimore në auditor. Përgjatë profileve për të cilat kërkohet akreditim, mësimdhënia rezulton të jetë realizuar e plotë. Edhe në rastet kur pedagogu ka munguar, studentët kanë pasur mundësinë ta zëvendësojnë në një orar të koordinuar me ta dhe të njoftuar paraprakisht. Rastet kur mësimi nuk është zhvilluar kanë qenë tejet sporadike dhe të justifikuara nga festat zyrtare apo pjesëmarrje të pedagogëve në aktivitete të rëndësishme shkencore. Gjatë procesit të mësimdhënies rëndësi i është kushtuar **përzgjedhjes së literaturës** e cila ka rezultuar të jetë e gjerë, sipas profileve përkatëse. Në disa raste literatura tejkalon dimensionin e materialeve të shkruara në trajtën e librave, pasi përfshin edhe tituj/botime të cilat mund të gjenden në biblioteka të tjera si Biblioteka Kombëtare apo edhe biblioteka online. Në këto raste, me qëllim që literatura të mund të aksesohet dhe përthitët më lehtë edhe nga studentë që mund të kenë pasur vështirësi me terminologjinë ligjore në gjuhë të huaj, pedagogët kanë ofruar edhe përgatitur materiale përmbledhëse në trajtën prezantimeve në PP me slide apo edhe të punimeve përmbledhëse të shkruara.

Prezantimet me slide në PP aktualisht kanë qënë pjesë e pandarë e leksioneve, gjë që është mundësuar edhe nga prania e projektorëve në salla. Kjo metodë i bën më të prekshme vizualisht temat e diskutimit dhe ndihmon studentët të arrijnë të përthithin materialin apo idetë kryesore menjëherë, si dhe i orienton ata që në të ardhme të mund të realizojnë në mënyrë të pavarur dhe skematike çështjet dhe nënçështjet kryesore të një teme. Mësimdhënia realizohet kryesisht bazuar në dy **kategori lëndësh/modulesh** - në lëndët e detyrueshme dhe në lëndët me zgjedhje. Nga takimi me studentët e profileve për të cilat kërkohet akreditim kishte sugjerime që departamentet të mund të rishikojnë:

- mënyrën e riorganizimit të raportit ndërmjet lëndë të detyrueshme/lëndë me zgjedhje duke i ofruar mundësi studentëve të zgjedhin lëndë nga një listë më e pasur dhe me programe më të profilizuara.

- mënyrën e rishikimit të kurrikulave të lëndëve të detyrueshme, duke u fokusuar më tepër tek çështjet specifike të disiplinës përkatëse, duke parashikuar më tepër raste studimi/casuse si dhe duke i lidhur një pjesë të temave me vetë profilin e studimit.

Mësimdhënia organizohet edhe mbi bazën e **teknikave interaktive** mes studentëve dhe studentëve dhe pedagogëve; në këtë këndvështrim vlen të përmenden detyrat në grup që ata realizojnë, prezantimet e tyre ku secili student prezanton pjesën e vet të punimit si dhe nëpërmjet kazuseve/rasteve nga praktika gjyqësore kombëtare si dhe jurisprudencë të gjykatave ndërkombëtare, kryesisht të GJEDNJ. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion gjatë vizitës në Universitetin "Albania University", grupi i vlerësimi të jashtëm konstatoj se **Njësia e Sigurimit të Cilësisë / NJSC** dhe Koordinatorët e departamenteve janë përgjegjës për të gjitha çështjet e lidhura me cilësinë e brendshme të cilat kanë si qëllim përmirësimin dhe ruajtjen në nivel të lartë të shërbimeve akademike dhe administrative të Albanian University'. NJSC përfshin jo vetëm grupet e vlerësimi, por edhe dokumentet që vërtetojnë zbatimin e programeve të studimit. Procesi i vlerësimi është i mbështetur në analizën e dokumenteve vlerësues (formularëve) si dhe në vizitat në auditor. Rezultatet e vlerësimi i jepen çdo departamenti apo fakulteti e më pas i kalohen drejtpërsëdrejti Zv- rektorit dhe Rektorit të Universitetit, parashikuar nga dokumenti i Politikave të Menazhimit të Cilësisë të IAL 'AU'.

Siç u përshkrua edhe më sipër, **realizimi i procesit mësimor** ka rezultuar në përputhshmëri i plotë me programin dhe parashikimet, me përjashtim të festave zyrtare apo pjesëmarrjes nga pedagogët në aktivitete të rëndësishme shkencore, megjithatë këto mungesa janë zëvendësuar në pjesën më të madhe të tyre, në koordinim të orarit me studentët. Lidhur me **cilësinë e mësimdhënies**, i referohemi kryesisht **kontrolleve periodike që zhvillohen ndaj studentëve** nëpërmjet **pyetësorëve** të hartuar e të miratuar paraprakisht nga Senati Akademik; sipas tyre studentët japin gjykimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies nga pedagogu përkatës. Referuar Formularit të Vlerësimi të studentit për procesin e mësimdhënies, vihet re që studenti jep vlerësim jo vetëm mbi aspekte të mësimdhënies, por edhe mbi mënyrën e komunikimit, sjelljen në auditor, si dhe mbi faktin nëse studenti ka vërejtur ose jo praktika korruptive si nga pedagogët ashtu edhe nga stafi administrativ (Pyetja 9 - 'A mendoni se në universitet ka sjellje korruptive në ndonjë nga punonjësit e administratës ose pedagogët?'). Krahas pyetjeve për cilësinë e mësimdhënies nga stafi akademik, pyetësori përmban edhe një pyetje të dedikuar, nëpërmjet të cilës studentit i jepet mundësia të vlerësojë stafin administrativ (Pyetja 8).

Një metodë tjetër vlerësimi që përdoret është **anketimi i drejtpërdrejtë** në klasë i studentëve nga vetë pedagogu i lëndës, i cili pyet në fillim ose në fund të çdo ore mësimi nëse studentët janë në kënaqur me mësimdhënien, materialet, mënyrën e shpjegimit, analizës, organizimit të procesit mësimor, etj., nëse ka problematika të reflektuara dhe si/sa mund të përmirësohen ato deri në përfundim të lëndës/modulit. Një mënyrë tjetër vlerësimi që rezultoi nga takimi është kontrolli i mësimdhënies nga

Shefi i Departamentit dhe Dekani. *RVB nuk jep të dhëna specifike për këto procese ndaj si ekspertë gjykojmë se ky është një element që mund të përmirësohet në të ardhmen. Gjatë takimit me pedagogët, konstatuam se IAL 'AU' nuk përdor metodën e vlerësimit 'peer to peer' pra të 'stafit nga stafi' ndaj për këtë mënyrë vlerësimi nuk ka të dhëna, e natyrshëm sugjerojmë që kjo mënyrë të fillojë të përdoret në të ardhmen si një nga komponentët e vlerësimit të pedagogut dhe të vlerësimit të cilësisë së stafit.*

Kontrolli i njohurive të studentëve në programin e Masterit që kërkohet akreditim realizohet në tre komponente :

- vlerësimi përgjatë seminareve, i cili zakonisht reflekton 10 % të vlerësimit përfundimtar
- vlerësimi bazuar në një testim të ndërmjetëm të njohurive, i cili zakonisht reflekton 30 % të vlerësimit përfundimtar, dhe
- vlerësimi bazuar në testimin përfundimtar i cili realizohet në përfundim të modulit, nëpërmjet testimit/eseve/detyrave në grup dhe zakonisht reflekton 60 % . Këto komponentë duke u alternuar plotësojnë tablonë e vlerësimit dhe bëjnë atë më objektive dhe reale.

Praktika Mësimore nuk përfshihet formalisht në programin e Masterit për të cilin është kërkuar akreditim, megjithatë diskutimet e rasteve konkrete gjatë leksioneve dhe seminareve, detyrat në grup që studentët duhet të realizojnë, vizitat në institucione të drejtësisë dhe takime me punonjës të specializuar të këtyre institucioneve, pjesëmarrja e tyre në aktivitete shkencore si konferenca apo botime, takimet/forumet me specialistë të fushavë përkatëse si dhe aktivitete të tjera, i mundësojnë studentëve që të rriten profesionalisht dhe të thellojnë profilizimin e tyre edhe në dimensionin praktik. Në këtë kontekst do të sugjerim që praktika mësimore të jetë pjesë edhe formalisht e programit/kurrikulës të Programit të Masterit. Në këtë kontekst IAL rekomandohet të hartojë një strategji për realizimin me efektivitet të Praktikës mësimore, të komponentëve përbërës të saj, të nënshkrimit të Memorandumeve të Bashkëpunimit me institucionet e ndryshme në fushën e drejtësisë, të përcaktojë një plan pune bazuar në numrin e studentëve dhe interesat e tyre profesionale dhe të mundësojë në përfundim edhe caktimin e një pedagogu/eksperti përgjegjës që të realizojë supervizimin akademik dhe profesional të temave në përfundim të programit.

IAL 'Albanian University' në programin e masterit për të cilin kërkon akreditim, e ka fokusuar kryesisht procesin e mësimdhënies në organizimin e leksioneve dhe seminareve, megjithatë nuk mungojnë debatet, diskutimet dhe forumet ku diskutohen çështjet me interes më të madh, nën drejtimin e pedagogëve përgjegjës. Mësimdhënia zhvillohet në vite akademike; viti akademik ka 2 semestra dhe një semestër ka 15 javë mësimore. Përgjatë profileve për të cilat kërkohet akreditim, mësimdhënia rezulton të jetë realizuar e plotë. Orari është hartuar në mënyrë të balancuar, që studenti të ketë mundësi edhe të ndjekë leksionet/seminaret/debatet, edhe të përgatitet individualisht.

Mësimdhënia realizohet kryesisht bazuar në dy kategori lëndësh/modulesh - në lëndët e detyrueshme dhe në lëndët me zgjedhje që mbulojnë në mënyrë të konsiderueshme transmetimin e njohurive, megjithatë me qëllim profilizimin e mëtejshëm të këtyre programeve ata sugjerojnë që departamentet të mund të rishikojnë disa kurrikula nga pikëpamja e thjeshtëzimit të tyre duke i bërë sa më praktike dhe më afër realitetit si dhe të mund të ofrojnë më shumë lëndë me zgjedhje. Nga ana e ekspertëve gjithashtu u gjykua me vend rishikimi pjesor i emërtimit të disa lëndëve/moduleve, në mënyrë që të reflektojnë plotësisht përmbajtjen e tij. Lidhur me ngarkesën dhe cilësinë e realizimit të saj Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Koordinatorët e departamenteve janë përgjegjës për të gjitha çështjet e lidhura me cilësinë Procesit të vlerësimit është i mbështetur në analizën e dokumenteve vlerësues (formularëve) si dhe në vizitat në auditor. Rezultatet e vlerësimit i jepen çdo departamenti apo fakulteti e më pas i kalohen drejtpërdrejtë Zv- rektorit dhe Rektorit të Universitetit. Cilësia e

mësimdhënies, vlerësohet kryesisht nëpërmjet kontrolleve periodike që zhvillohen ndaj studentëve; ata plotësojnë pyetësorëve të hartuar e të miratuar paraprakisht nga Senati Akademik dhe japin gjykimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies nga pedagogu përkatës dhe stafi administrativ. IAL 'AU' nuk përdor metodën e vlerësimit 'peer to peer' pra të 'stafit nga stafi' ndaj sugjerojmë që kjo mënyrë të fillojë të përdoret në të ardhmen si një nga komponentët e vlerësimit të pedagogut dhe të vlerësimit të cilësisë së stafit.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Në bazë të nenit 29 të Rregullores së Fakultetit të Shkencave Shoqërore, kanë të drejtë të aplikojnë për t'u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve të gjithë studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve (180 ECTS) në një nga institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Këtë të drejtë e gezojnë dhe shtetasit e huaj bazuar në një marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe. Të gjithë aplikantët duhet të plotësojnë dhe standartet/kriteret e përcaktuara në rregulloren e studimeve Msc në programin përkatës të studimeve.

Në bazë të nenit 9 të rregullores së programit të studimeve Msc "Në Shkenca Juridike", për të ndjekur studimet në këtë program (Cikli i dytë e studimeve) duhet: Të zotërojnë një diplomë "Bachelor" të ciklit të parë të studimeve (180 kredite).

Studentët pranohen në bazë të kriterëve të miratuara dhe që përcaktohen nga komisioni i pranimit të njësisë bazë/departamentit.

Në të këtë dispozitë nuk citohen kriterë konkrete. Në të njëjtën dispozitë ka një parashikim në lidhje me vazhdimin e studimeve për në ciklin e dytë; nga të gjithë ata studimet që kanë mbaruar ciklin e parë jo në disiplinën bazë. Këta studentë pranohen vetëm nëse komisioni përkatës vlerësues konstaton që diploma e tyre në ciklin e parë të studimeve ka një përputhje në masën 66% me programin e studimit që ata duan të ndjekin.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Studentët që ndjekin këtë program duhet të zotërojnë një diplomë "Bachelor" të ciklit të parë të studimeve (180 kredite). Studentët pranohen në bazë të kriterëve të miratuara dhe që përcaktohen nga komisioni i pranimit të njësisë bazë/departamentit. Ky është një rregull i përcaktuar në nenin 9 të rregullores së programit të studimit "Master në fushën e Shkencave Juridike". Në këtë dispozitë nuk citohen kriterë konkrete. Në të njëjtën dispozitë ka një parashikim në lidhje me vazhdimin e studimeve për në ciklin e dytë; nga të gjithë ata studimet që kanë mbaruar ciklin e parë jo në disiplinën bazë. Këta studentë pranohen vetëm nëse komisioni përkatës vlerësues konstaton që diploma e tyre në ciklin e parë të studimeve ka një përputhje në masën 66% me programin e studimit që ata duan të ndjekin.

Në tabelat më poshtë janë të dhënat që disponon departamenti për vitet akademike 2011-2016, në lidhje me: notën mesatare të studentëve në hyrje dhe më pas; numrin e studentëve dhe kalueshmëria e tyre së bashku me notën mesatare; numrin e studentëve të diplomuar dhe të punësuar.

Programi i studimit Msc ne Shkenca Juridike	Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)	Nota Mesatare	Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)	Nota Mesatare
Msh. Shkenca	5	7.75	3	7.6

Juridike -E drejte private 2011				
Msh. Shkenca Juridike E drejte penale 2011	2	6.23	0	-
Msh. Shkenca Juridike- E drejte private 2012	31	8.14	18	9
Msh. Shkenca Juridike – E Drejte Penale 2012	15	6.45	9	8.5
Msh. Shkenca Juridike – E Drejte Publike dhe Administrative 2012	21	8.25	2	7.2
Msh. Shkenca Juridike – Marrëdhënie Ndërkombëtare 2012	1	6.92	1	8.15
Msh. Shkenca Juridike – E Drejtë Ndërkombëtare dhe BE 2012	1	7.25	0	-
Msh. Shkenca Juridike- E drejte private 2013	13	7.5	Dipl 2015	-
Msh. Shkenca Juridike – E Drejte Penale 2013	15	7.52	Dipl 2015	-
Msh. Shkenca Juridike – E Drejtë Publike dhe Administrative 2013	22	7.86	Dipl 2015	-
Msh. Shkenca Juridike- E drejte private 2014	12	7.35	Dipl 2016	-
Msh. Shkenca	12	8.85	Dipl 2016	-

Juridike – E Drejtë Publike dhe Administrative 2014				
Msh. Shkenca Juridike E drejte penale 2015	20			
Msh. Shkenca Juridike- E drejte private 2015	16			
Msh. Shkenca Juridike – E Drejte Penale 2015	15			
Msh. Shkenca Juridike – E Drejte Publike dhe Administrative 2015	16			
Msh. Shkenca Juridike – Marrëdhënie Ndërkombëtare 2015	0			
Msh. Shkenca Juridike – E Drejtë Ndërkombëtare dhe BE 2015	0			
Totali	211 studente			

	Programet e studimit që ofron IAL	Numri total i studentëve	Kalueshmëria në total	Nota mesatare për numrin total të studentëve
II 2011	1. MSc në të drejtë private 2. MSc në të drejtë penale	5 2	3 0	7.6
2012-2013	1. MSc në të drejtë private 2. MSc në të drejtë penale 3. MSc në E Drejtë Publike dhe Adm 4. MSc në Marrëdhënie	31 15 21 1 1	25 13 11 1 0	

	Ndërkomb. 5. MSc në E Drejtë Ndërkomb. dhe BE			
2013- 2014	1. MSc në të drejtë private 2. MSc në të drejtë penale 3. MSc në E Drejtë Publike dhe Adm	13 18 28	8 15 21	Dipl 2015
2014- 2015	1. MSc në të drejtë private 2. MSc në E Drejtë Publike dhe Adm	16 20	-	

	Programet e studimit që ofron IAL	Viti akademik	Numri total të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
I	1. MSc në të drejtë private 2. MSc në të drejtë penale	2011 2011	3 0	Nuk rezulton të ketë	Nuk rezulton të ketë
II	1. MSc në të drejtë private 2. MSc në të drejtë penale 3. MSc në E Drejtë Publike dhe Adm 4. MSc në Marrëdhënie Ndërkomb. 5. MSc në E Drejtë Ndërkomb. dhe BE	2012 2012 2012 2012	19 9 2 1 0	Nuk rezulton të ketë	Nuk rezulton të ketë
III	1. MSc në të drejtë private 2. MSc në të drejtë penale 3. MSc në E Drejtë Publike dhe Administrative	2013 2013 2013 2013	Dipl 2015 Dipl 2015 Dipl 2015 Dipl 2015	Nuk rezulton të ketë	Nuk rezulton të ketë
IV	1. MSc në të drejtë private 2. MSc në E Drejtë Publike dhe Administrative	2014 2014	Dipl 2016 Dipl 2016		

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Studentët që ndjekin këto programe studimi Msc “Në Shkencat Juridike” duhet të zotërojnë një diplomë “Bachelor” të ciklit të parë të studimeve (180 kredite).</p> <p>Studentët pranojnë në bazë të kriterëve të miratuara dhe që përcaktohen nga komisioni i pranimit të njësisë bazë/departamentit. Ky është një rregull i përcaktuar në nenin 9 të rregullores së programit të studimit “Master në fushën e Shkencave Juridike”. Në këtë dispozitë nuk citohen kriteret konkrete. Në të njëjtën dispozitë ka një parashikim në lidhje me vazhdimin e studimeve për në ciklin e dytë; nga të gjithë ata studimet që kanë mbaruar ciklin e parë jo në disiplinën bazë. Këta studentë pranojnë vetëm nëse komisioni përkatës vlerësues konstaton që diploma e tyre në ciklin e parë të studimeve ka një përputhje në masën 66% me programin e studimit që ata duan të ndjekin.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Departamenti informon studentët në lidhje me punësimin e mundshëm, nëpërmjet Zyres së Karrierës dhe Alumni, e cila është një strukturë e krijuar së fundi dhe që ka në përbërje një personel të përkushtuar.</p> <p>Studentëve ju ofrohen këshillime dhe ata informohen dhe nëpërmjet udhëzuesve të ndryshëm që Zyra e Karrierës publikon.</p> <p>Studentët informohen nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë mbi akreditimin e institucionit/programit përkatës.</p>
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Akreditimi i programit “Master i Shkencave në Shkenca Juridike me profile” kërkohet për herë të parë.</p> <p>Në këtë program studimi janë diplomuar 28 studentë (të diplomuar përpara akreditimit).</p> <p>Universiteti disponon të dhënat/statistikat për numrin e të diplomuarve.</p> <p>Universiteti dispon të dhëna për ecurinë e studentëve që nga moment i pranimit/rregjistrimit deri në momentin e diplomimit, në programin e studimeve “Master në Shkenca Juridike” me profilet përkatëse.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Departamenti ka një bazë të dhënash për punësimin e studentëve pas diplomimit, i cili në asnjë rast nuk lidhet me diplomimin e tyre.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Departamenti nëpërmjet sekretarisë mësimore informon studentët për vlerësimet përfundimtare të fituara.</p> <p>Pedagogët informojnë për vlerësimet paraprake, duke ju dhënë të drejtë të ballafaqohen me provimet dhe në cdo rast studentët kanë të drejtë të kërkojnë të informohen në detaje në lidhje me pikët e fituara.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Universiteti i ofron këshillim të vazhdueshëm studentëve nëpërmjet Zyrës së Karrierës, e cila dhe pse në fapat e parë të krijimit ka botuar një udhëzues për zhvillimin e karrierës.</p> <p>Kjo Zyrë i ndihmon studentët të krijojnë kontakte për intership duke patur një data basis të institucioneve dhe kompanive.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Universiteti ndjek një politikë ta caktuar për pranimin e studentëve për në ciklin e dytë të studimeve. Kjo politikë është e përcaktuar në aktet nëligjore të institucionit/rregullorja e programit të studimit “Master</p>	

Shkencor në Shkenca Juridike' me profile.

Universiteti mban në mënyrë të rregullt të dhënat mbi vlerësimin e studentëve dhe i informon ata në mënyrë verbale. Institucioni është përfshirë në një projekt për informimin on-line të studentëve për vlerësimet/sekretari me skedar në formë elektronike.

Universiteti ka një bazë të dhënash për punësimin e studentëve dhe Zyra e Karrierës dhe Alumni kanë filluar të funksionojnë në mënyrë aktive për gjatë gjithë vitit akademik. Kjo zyrë informon studentët nëpërmjet udhëzuesve dhe takimeve që organizon me studentët.

Standartet e mësipërme përmbushen plotësisht.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkimore

Terma reference:

Në programin e studimit Msc "Në Shkencat Juridike" (sipas profileve përkatëse) nuk ka një politikë kërkimi shkencor në lidhje me: botimet në vite, projektet , pjesëmarrje në aktivitete brenda dhe jashtë vendit apo lidhje të kërkimit me mësimdhënien.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Në tabelat më poshtë janë të dhënat që disponon departamenti për vitet akademike 2011-2016, në lidhje me: aktivitetet individuale në rang institucioni dhe pjesëmarrjen si partnerë në projekte Kombëtare apo Ndërkombëtare.

Nuk ka të dhëna që lidhen në mënyrë specifike më Departamentin e Shkencave Juridike.

1.	Nr i botimeve nga personaliteti akademik efektiv i IAL	342
2.	Nr i projekteve kërkimore të fituara	-
3.	Nr i projekteve të zbatuara	-
4.	Nr i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	31+ 3+ 3
5.	Nr i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL	12
6.	Nr i kërkimit shkencor me procesin mësimor	52
7.	Nr i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	7
8.	Nr i Çmimeve Kombëtare	-

Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	1
Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj	35 (ose orë mësimore)

Numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	20
Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL	
Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	
Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	10
Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	

Numri i botimeve të realizuara nga “Albania University Press” për Departamentin e Shkencave Juridike është pesë; të cilat janë tekste akademike ose përmbledhje legjislacioni. Pedagogët që kanë botuar pranë shtëpisë botuese të këtij Universiteti janë pedagoge të angazhuar në procesin akademik (PAK) ose bashkëpunëtor pranë këtij departamenti: “E drejta administrative” me autor Prof.Dr. Ermir Dobjani; “E drejta Kushtetuese e Krahasuar” me autor Erlir Puto; “Kriminalistika” me autor Estref Myftaraj; “Përmbledhje legjislacioni” me autor Ervin Karamuco.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Personeli akademi i angazhuar në këtë program studimi Msc “Në Shkencat Juridike” është i përfshirë në botime të artikujve shkencorë në revistën e universitetit “Optime” si dhe në revista të tjera shkencore..
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Këto kriteret nuk aplikohet në këtë program.
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor; Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë	Departamenti organizon programe trajnimi profesional, që lidhen me metodologjinë e mësimdhënies; vlerësimin e studentëve .etj. Ka një ndërveprim me Qendrën Kërkimore dhe Zyrën e Karrierës. Zyrën e Karrierës ka botuar dhe një Udhëzues për karrierën.

vendit.	
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Departamenti disponon një bazë të dhënash me veprimtarinë kërkimore shkencore të cdo anëtari të stafit akademik këto të dhëna përmbajnë botimet në konferenca; revista; tekste akademike dhe pjesëmarrje të tjera në veprimtari me natyrë kërkimore shkencore.</p> <p>GVJ nuk zotëron në mënyrë zyrtare të dhëna të detajuara për punën kërkimore shkencore të cdo anëtari të stafit akademik edhe pse u njoh gjatë vizitës nga drejtuesi i programit të studimeve Msc “Në Shkencat Juridike” me veprimtarinë kërkimore-shkencore të stafit të angazhuar në këtë program studimi Msc “Në Shkencat Juridike” (sipas profileve).</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Universiteti ka ngritur struktura që mbështesin kërkimin shkencor. Kërkimi shkencor është një “detyrim” për stafin akademik efektivë dhe konsiderohet si pjesë e ngarkesës mësimore, ku secili pedagogë paraqet në fillim të vitit akademik objektivat e tij në lidhje me kërkimin shkencor.</p> <p>RVB nuk përmban të dhëna të detajuara për kërkimin shkencor që është realizuar nga ana e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie në Msc “Në Shkencat Juridike” (sipas profileve).</p> <p>Universiteti ka një Qëndër Kërkimore Shkencore, e cila realizon botimin dy herë në vit të revistës shkencore “Optime”, në funksion të të gjitha njësive bazë të institucionit.</p> <p>Standartet e mësipërme përmbushen plotësisht.</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Departamenti i Shkencave Juridike ka një bashkëpunim me institucionet e pushtetit gjyqësor dhe me disa nga organizatat joqeveritare që veprojnë në fushën e iniciativës ligjore si dhe me disa zyra avokatie.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Në tabelat më poshtë janë të dhënat që disponon departamenti për vitet akademike 2011-2015, në lidhje me: bashkëpunimin me institucionet dhe organizatat bashkëpunuese.

Institucionet qeveritare bashkëpunuese		Lloji i bashkëpunimit
	Gjykata Kushtetuese	Për realizimin e praktikave profesionale.
	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Dhoma Civile)	
	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë(Dhoma Penale)	

	Gjykata e Krimeve të Rënda	
	Policia e Shtetit Shqiptar	
	Ministria e Drejtësisë	
Organizatrat Profesionale		Lloji i bashkëpunimit
	Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare	Për realizimin e praktikave profesionale
Komuniteti i biznesit, tregu i punës		Lloji i bashkëpunimit
	Studio ligjore – Bozo and Associates	Për realizimin e praktikave profesionale
	Studio ligjore – Lama and Attorney”	

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Universiteti/departamenti dëshmon që ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucioni publike dhe private, <i>por këto marrëveshje nuk duken të jenë të formalizuara në mënyrë specifike për realizimin e praktikës profesionale në programin e studimit “Master i Shkencave Juridike” (sipas profileve) për çdo student.</i></p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Juridike ka një marrëdhënie ndërveprimi, nxitëse dhe bashkëpunuese ndërmjet personelit akademik në kuadër të shkëmbimit të informacionit. Autoritetet drejtuese dhe stafi akademik kanë një komunikim të mirë institucional dhe kjo duket dhe në analizën e hapur që ata bëjnë ndërmjet tyre në auditoret dhe në nivel shkencor. Për mbarëvajtjen e punës dhe mbajtjen e përgjegjësisë nga ana e personeli akademik dhe administrative, aktet e brendshme juridike të nxjerra nga institucioni janë shumë të qarta. Aktorët</p>

	<p>akademik të institucionit marrin përgjegjësitë e duhura dhe kjo ishte një nga faktet që ne konstatuam lehtësisht në vizitën tonë.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti në funksion dhe të programit të studimit ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit në përgjithësi.</p> <p><i>Njësia bazë/departamenti nuk ka një bashkëpunim në terma që lidhen me kryerjen e praktikës profesionale individuale për secilin student (një marrëveshje ndërmjet studentit- pedagogut mentor- mbikëqyrësit të institucionit)</i></p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Edhe pse Universiteti në tërësinë e tij apo njësi të caktuara bazë në përbërje të tij kanë një traditë në zhvillimin e praktikës profesionale në strukturat e ngritura pranë institucionit; në Departamentin e Shkencave Juridike nuk ka një bashkëpunim në terma konkrete që lidhen me kryerjen e praktikës profesionale individuale nga ana e cdo studenti në formën e një marrëveshje juridike për zhvillimin e praktikës të firmosur dhe hartuar me vullnetin e tre palëve : studentit – mentorit të praktikës/drejtuesit perkatës/pedagogut dhe mbikëqyrësit të institucionit.</p> <p><i>Në nenin 40 të Rregulloren së Fakultetit të Shkencave Shoqërore (ku ben pjesë dhe Departamenti i Shkencave Juridike) është e parashikuar kryerja e detyrueshme e praktikës profesionale nga ana e studentit dhe se ajo vlerësohet me notë sic do lëndë tjetër.Në nenin 6/b të rregullores së programit të studimit Msc “Në Shkencat Juridike”, parashikohen 6 ECTS në kategorinë e disiplinave të njohjes së informatikës dhe praktikës apo metodave të kërkimit.</i></p> <p><i>Nuk ka një parashikim në terma/orë mësimore/kredite konkrete në lidhje me zhvillimin e praktikë si dhe një marrëveshje ndërmjet pedagogut mentor dhe mbikëqyrësit të institucionit, për zhvillimin e praktikës nga ana e studentit.</i></p> <p><i>Standartet e mësipërme përmbushen pothuajse plotësisht</i></p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

a. Pika të forta:

- 1) Bashkëpunim ndërmjet departamenteve të Fakulteti të Shkencave Shoqërore (ku Departamenti i Shkencave Juridike bën pjesë), në drejtim të punës kërkimore shkencore, vlerësohet mjaft pozitivisht; disa nga artikujt shkencor të botuara në revistën shkencore të Universitetit (revista "Optime": ISSN 2220-461X), janë rezultat i një bashkëpunim me bashkëautorësitë pedagogë të departamenteve të këtij fakulteti.
- 2) Organizimi i "Konferencave Studentore" me tema nga aktualiteti.
- 3) Botimi i "Udhëzuesit për Zhvillimin e Karrierës", tregon për angazhimin e institucionit për të mbështetur studentët, në lidhje me aplikimin për punë dhe prezantimin e tyre për një vend pune.
- 4) Koordinimi i punës mësimore me procesin administrativ; njësitë akademike dhe zyrat përkatëse që realizojnë procesin e administrimit të procesit akademik janë në funksion të studentëve.

b. Pika të dobëta:

- 1) Në kurikulën e programit të studimit Msc "Në Shkencat Juridike" (sipas profileve), nuk është përfshirë praktika si një lëndë/modul i vecantë. Praktika duhet të konsiderohet: a) si një modul me vete dhe të vlerësohet si të gjitha modulet e tjera (me orë pune në auditor dhe orë pune pranë institucionit) si dhe të parashikoheshin rregulla që lidhen me rastet kur nuk përmbushen kërkesat që lidhen me këtë modul ose; b) si pjesë e modulit të tezës së diplomimit, por me kredite dhe vlerësim të ndarë. "Udhëzuesi për Diplomimin" dhe "Udhëzuesi për Praktikë" duhet të jenë të miratuara në mënyrë specifike me këtë program Msc, prej autoriteve përkatëse. Në këto dy udhëzues, duhet të përfshihen të gjitha informacionet dhe formularët e nevojshëm që plotësohen nga ana e udhëheqësit, mentorit të praktikës dhe studentit, përpara realizimit të mbrojtjes së tezës dhe përfundimit të praktikës.
- 2) Departamenti nuk aplikon ndonjë standart të vetin në lidhje me vlerësimin e procesit të mësimdhënies dhe nxënies, përveç atij që është në rang institucional. Departamenti i Shkencave Juridike nuk përdor instrumentin e vlerësimit të stafit nga stafi "peer to peer".
- 3) Përfshirja e studentëve (të ciklit të dytë të studimeve Msc) në botimet shkencore të universitetit.
- 4) Departamenti i Shkencave Juridike duhet të bëjë një studim mbi nevojat reale të tregut të punës për të përshtatur më mirë përmbajtjen e programeve Msc "Në Shkencat Juridike" (sipas profileve) me këto nevoja.

c. Mundësitë:

- 1) Në lidhje me pikën (a): Drejtuesi i njësisë dhe autoritetet e tjera të institucionit kanë kapacitetin akademik dhe përkushtimin e duhur institucional për të realizuar përmbushjen e këtij elementi strukturor akademik. Vizioni i tyre për institucionin dhe njësitë ndihmëse akademike pranë këtij institucioni (Zyra e Kurikulave dhe e Karrierës) do të mundësojnë përmbushjen e këtij elementi akademik. Stafit që është pjesë e këtij programi ka përvojën e duhur akademike dhe profesionale për të realizuar më së miri përmbushjen e këtij elementi kurrikular.
- 2) Në lidhje me pikën (b): Departamenti i Shkencave Juridike dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë kanë kapacitetin e duhur për të realizuar pyetsorë të vlerësimit të stafit nga stafi. Stafit akademik ka një frymë transparence në drejtim të përmirësimit të metodologjisë dhe përmbajtjes së procesit të mësimdhënies.
- 3) Në lidhje me pikën (c): Revista Shkencore periodike që nxjerr universiteti ka mundësinë e një rubrike dedikuar punimeve shkencore më të spikatura të studentëve. Kjo mundësi që ka institucioni do të mund të nxisë edhe punën e studentëve më të mirë të këtij departamenti që në bashkëpunim dhe me udhëheqësit e tyre të përballen me një lexues të kualifikuar.
- 4) Në lidhje me pikën (d): Departamenti ka frymën e duhur akademi për të përshtatur programet e studimit me nevojat e tregut.

d. Pengesat:

Nuk konstatojmë asnjë pengesë për të mënjeluar pikat që ne si vlerësues të jashtëm i vlerësuam si “pika të dobëta”

SUMMARY ANALYSIS ON THE IMPLEMENTATION OF THE MASTER CURRICULA/PROGRAMME

a. Strength Points:

- 1) In the opinion of external evaluators it is very positively the collaboration that exists between the member staff of the departments of the Faculty of Social Sciences with regards to scientific research. By considering the scientific papers published on the Scientific Review of the University ('Optime' - ISSN 2220-461X) as the contribution and the collaboration of the academic staff of the departments of this Faculty.
- 2) The organization of 'Students' Conferences' organized based on the relevant topics.
- 3) The publication of the 'Manual of Career' by the university it's the way to support students how to apply for a job and how to present himself.
- 4) The coordination of teaching process with the administrative one. There is an effective collaboration between academic and administrative staff to conduct the administrative process, from which benefit the students.

b. Weak Points :

- 1) At the curriculum of the study programmes “Master of Science” in Law (*according to profiles for which accreditation is required*), the course of internship is not part of the courses offered by the study programmes. The course/module of internship should have been considered as a separate module (based on the number of class hours and independent hours at the required institution) or as a part of dissertation. The relevant authorities of the Law Department should have to approve the “Guide of Dissertation” and the “Guide of Internship” to the specific study programmes “Master of Science”. These two legal documents should include all necessary information and all required templates to be filled by mentor of internship, supervisor of master theses and the student before the finalizing the module of “Internship and Dissertation”.
- 2) The Department does not apply any standard of its own with regards to evaluation of teaching and learning process other than that adopted in the institutional level; likewise it does not apply 'peer to peer' staff evaluation technique/method.
- 3) Involvement of the students of the second level of study in the scientific publications published by the university.
- 4) The Law Department may conduct a study to evident actual needs of the labor market in order to better align master programs' content with those needs.

c. Opportunities:

- 1) In reference to *Weak point. 1 (Internship)* - Head of Department as well as other authorities of the university, have the academic capacity and appropriate institutional commitment to fulfill this academic structural element. The institutional vision and the support of academic and administrative staff (Curricula and Career Office) will be able to fulfill this academic process. The staff involved in these programs possesses the necessary academic and professional experience to fulfill the best performance of this module.
- 2) In reference to *Weak point. 2* - Law Department and Quality Assurance Office possesses the capacity to carry out evaluation forms to staff by the staff / peer to peer evaluation. Also, the academic staff reflects a spirit of transparency in terms of improving teaching techniques.
- 3) In reference to *Weak point. 3* - Scientific Review of the University, which is being published periodically, dedicates a space to the most prominent scientific work of students; this opportunity

could encourage also the best students of the department to publish in co-authors with their mentors, in order to successfully face and challenge qualified readership.

- 4) In reference to *Weak point. 4* - Department possesses the right academic enthusiasm and energy to adapt masters' programs with market needs.


d. Threats:

In the opinion of external evaluators about the 'Weakness points' of the study programmes "Master of Science", the University will be able to overcome all of the *academically barriers*.

Ekspertet e Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Oldashi

Prof. Asoc. Dr. Mirela P. Bogdani



ANEKSI 1

Tabela 1: Numri aktual i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) të angazhuar në programet e studimit Msc në “Shkenca Juridike”.

IAL	Numri i PAE		Numri i PAK		Totali	
	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada
Fakulteti i Shkencave Shoqërore Departamenti i shkencave juridike Programet e studimit Msc	5	4	9	9	14	13

Viti akademik 2014 - 2015

IAL	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Totali	
	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada
Fakulteti i Shkencave Shoqërore – Departamenti i shkencave juridike	6	6	9	9	9	-	24	15

ANEKSI 2

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK), të angazhuar në programet e studimit Msc “Shkenca Juridike”, për vitin akademik 2015-2016.

Departamenti i Shkencave Juridike/ Programet e studimit Msc							
Personeli Akademik Efektiv (PAE) Emër Mbiemër	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (PAK) Emër Mbiemër		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time	
1	Renata Tokrri	Pedagoge	Dr	1	Argita Malltezi	Prof. Dr	Pedagoge

		në "AU"					pranë UT, Fakulteti i Drejtësisë
2	Jorida Xhafaj	Pedagoge në "AU"	Dr	2	Aldo Shkëmbi	Dr	Zyrë avokatie
3	Pjereta Agalliu	Pedagoge në "AU"	Drnt	3	Luan Hasneziri	Dr	Gjyqtar në Gjykatën e Krimeve të Rënda
4	Ismail Tafani	Drejtues i departame ntit të Shkencave Juridike	Dr	4	Dariel Sina	Prof.Asoc .Dr	Universiteti i Nju Jorkut
5	Vasil Dodi	Pedagoge në "AU"	Dr	5	Juliana Latifi	Prof. Dr	Kuvendi i Republikës Së Shqipërisë
				6	Lulëzim Lelçaj	Dr	Shoqëria e Sigurimit Sigal-Uniq Group
				7	Merita Xhumari	Prof.Asoc .Dr	Pedagoge pranë UT, Fakulteti i Shkencave Sociale
				8	Valbona Sanxhaktari	Dr	Kryeministri
				9	Ervin Karamuço	Dr	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

Viti akademik 2011 - 2015

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Departamenti i Shkencave Juridike						
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time	
1 Fatmir Tartale	Dekan i fakultetit të Shkencave Shoqërore	Prof. Asoc. Dr	1 Juliana Latifi	Prof. Dr	Kuvendi i Republikës Së Shqipërisë	
2 Rezart Bejkaj	Pedagog në "AU"	Dr	2 Argita Malltezi	Prof. Dr	Pedagogë pranë UT, Fakulteti i	

							Drejtësisë
3	Ismail Tafani	Drejtues i departamentit të Shkencave Juridike	Dr	3	Merita Xhumari	Prof.Asoc .Dr	Pedagoge pranë UT, Fakulteti i Shkencave Sociale
4	Jurida Dimroçi	Pedagog në "AU"	Dr	4	Lulëzim Lelçaj	Dr	Shoqëria e Sigurimit Sigal-Uniqa Group
5	Jorida Xhafaj	Pedagoge në "AU"	Dr	5	Luan Hasneziri	Dr	Gjyqtar në Gjykatën e Krimeve të Rënda
6	Bledar Ilia	Drejtues i Departamentit të Shkencave Juridike	Dr	6	Valbona Pajo	Dr	Gjykata Kushtetuese
				7	Eriona Katro	Prof. Dr	UT
				8	Luan Veliqoti	Prof. Asoc. Dr	Universiteti "Luarasi"
				9	Vasil Dodi	Dr	-

ANEKSI 3

Tabela 3: Nuk ka të dhëna për Këshillin Shkencor të Programit të studimit Msc "Në Shkencat Juridike". Ka të dhëna për Përgjegjës të programeve të studimit Msc si më poshtë:

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor
Ismail Tafani	Phd	Përgjegjës i Departamentit të Shkencave Juridike dhe i programeve Msc

ANEKSI 4

Tabela 4: Të dhënat numerike sipas kualifikimit të stafit akademik të angazhuar në programin Msc "Shkenca Juridike"/Departamenti Shkenca Juridike, si dhe raportet midis tyre në lidhje me titujt/gradat dhe kualifikimet e tjera (PAE/PAK).

Titulli	Departamenti i Shkencave Juridike/ programi Msc ne "Shkenca Juridike"		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	-	2	0 / 2
Profesorë të As.	-	2	0 / 2
Doktorë	4	5	4 / 5
Pedagogë (pa tituj)	-	-	1 / 0
Asistentë me Ma	1	-	-
Asistentë pa Ma	-	-	-
Personeli Administrativ	9	-	9 / 0

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe administrativ me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	-	-	-	-	-
As. Prof	-	-	-	-	-
Doktorë	4	-	-	-	-
Pedagogë (pa tituj)	-	1	-	-	-
Asistentë me Ma	-	-	-	-	-
Asistentë pa Ma	-	-	-	-	-
Personeli Administrativ	8	1	-	-	-

Personeli sipas titujve/gradave	Numri i Personelit Akademik me Kontratë me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	-	1	1	-	-
As. Prof	-	1	1	-	-
Doktorë	-	5	-	-	-
Pedagogë (pa tituj)	-	-	-	-	-
Asistentë me Ma	-	-	-	-	-
Asistentë pa Ma	-	-	-	-	-

Titulli	Departamenti i Shkencave Juridike		
	PAE femra	PAE Meshkuj	Raporti M/F
Profesorë	-	-	-
Profesorë të As.	-	-	-
Doktorë	2	2	2 / 2
Pedagogë (pa tituj)	1	-	1 / 0
Asistentë me Ma	-	-	-
Asistentë pa Ma	-	-	-
Personeli Administrativ	7	2	7 / 2

Viti akademik 2011 - 2015

Titulli	Departamenti i Shkencave Juridike		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	0	3	0 / 3
Profesorë të As.	1	2	1 / 2
Doktorë	5	4	5 / 4
Pedagogë (pa tituj)	0	0	0 / 0
Asistentë me Ma	0	0	0 / 0
Asistentë pa Ma	0	0	0 / 0
Personeli Administrativ	9	0	9 / 0

Titulli	Departamenti i Shkencave Juridike		
	PAE femra	PAE Meshkuj	Raporti M/F
Profesorë	0	0	0 / 0
Profesorë të As.	0	1	0 / 1
Doktorë	2	3	2 / 3
Pedagogë (pa tituj)	0	0	0 / 0
Asistentë me Ma	0	0	0 / 0
Asistentë pa Ma	0	0	0 / 0
Personeli Administrativ	7	2	7 / 2

Personeli sipas /gradave	Numri i Personelit Akademik Efektiv dhe administrativ me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	-	-	-	-	-
As. Prof	-	-	1	-	-
Doktorë	4	1	-	-	-
Pedagogë (pa tituj)	-	-	-	-	-
Asistentë me Ma	-	-	-	-	-
Asistentë pa Ma	-	-	-	-	-
Personeli Administrativ	8	1	-	-	-

Personeli sipas titujve/gradave	Numri i Personelit Akademik me Kontratë me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	1	2	-	-	-
As. Prof	-	-	2	-	-
Doktorë	1	3	-	-	-

Pedagogë (pa tituj)	-	-	-	-	-
Asistentë me Ma	-	-	-	-	-
Asistentë pa Ma	-	-	-	-	-

ANEKSI 5

Tabela 5: Të dhëna për anëtarët e NJSBC

Anëtarët e NJSBC		Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Elona Mehmeti	Drejtuese	5 vite
2.	Sidita Coniku	Anëtare	1 vit
3.	Leudita Docaj	Anëtare	3 vite

ANEKSI 6

Tabela 6: Nuk ka asnjë ndryshime në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara.

Viti I (Viti II)	Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore												Gjithsej		
					Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë					
					ECTS	Në auditor	Pavarur	ECTS	Në auditor	Pavarur	ECTS	Në auditor	Pavarur	ECTS	Në auditor	Pavarur			
1	E drejte civile e avancuar	1	6	4	4	45	55	2	15	35						60	90	150	1
2	E drejta penale (pjesa e posaçme)	1	9	6	5	60	65	4	30	70						90	135	225	1
3	E drejtë e Shoqërive Tregtare	1	9	6	5	60	65	4	30	70						90	135	225	1
4	Metoda të	1	9	6	5	60	65	4	3	70						90	135	225	1

	kërkimit Shkencor								0										
5	Procedurë Civile e Përparuar	2	9	6	5	60	65	4	3 0	70						90	135	225	1
6	Procedurë penale e përparuar	2	9	6	5	60	65	4	3 0	70						90	135	225	1
7	Lëndë me zgjedhje	2	6	4	4	45	55	2	1 5	35						60	90	150	1
8	Lëndë me zgjedhje	2	6	4	4	45	55	2	1 5	35						60	90	150	1
	Totali		60	42	37	435	490	2 6	1 9 5	455						63 0	945	1575	8
9	E drejta administrative (pjesa e posaçme)	½	6	4	4	45	55	2	1 5	35						60	90	150	1
10	E drejtë e detyrimeve e avancuar	½	6	4	4	45	55	2	1 5	35						60	90	150	1
11	Lëndë me zgjedhje	½	6	4	4	45	55	2	1 5	35						60	90	150	1
12	Lëndë me zgjedhje	½	6	4	4	45	55	2	1 5	35						60	90	150	1
13	E drejta ndërkombëtar e dhe komunitare e punës	½	6	4	4	45	55	2	1 5	35						60	90	150	1
	Teza e Diplomës	2	30													10 0	650	750	
	Totali		30	20	20	225	275	1 0	7 5	175						30 0	450	750	5

ANEKSI 7

Tabela 7: Planet mësimore të programeve të studimit Msc “Në Shkeca Juridike” (në profilet: E Drejte Penale dhe E Drejtë Private) të lidhura me personelin akademik përkatës të angazhuar.

Lënda /Moduli		Pedagogu /Pedagogët Përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1	E Drejtë Civile e Avancuar	Juliana Latifi	Prof. Dr	Departamenti i Shkencave Juridike	PAK
2	E Drejtë Penale (Pjesa e Posaçme)	Lulzim Lelçaj	Dr	Departamenti i Shkencave Juridike	PAK
3	E Drejtë e Shoqërive Tregtare	Argita Malltezi	Prof. Dr	Departamenti i Shkencave Juridike	PAK
4	Metoda të Kërkimit Shkencor	Merita Xhumari	Prof.Asoc. Dr	Departamenti i Shkencave Sociale	PAK
5	E Drejtë e Detyrimeve e Avancuar	Luan Hasneziri	Dr	Departamenti i Shkencave Juridike	PAK
6	E Drejtë Administrative (Pjesa e posaçme)	Dariel Sina	Prof.Asoc. Dr	Departamenti i Shkencave Juridike	PAK
7	E Drejtë Ndërkombëtare dhe Komunitare e Punës	Jorida Xhafaj	Dr	Departamenti i Shkencave Juridike	PAE
8	E Drejtë Ndërkombëtare dhe Komunitare e Punës	Pjereta Agalliu	Drnt	Departamenti i Shkencave Juridike	PAE
9	E Drejtë Kushtetuese e Krahasuar	Renata Tokrri	Dr	Departamenti i Shkencave Juridike	PAE
10	E Drejtë e Prokurimeve	Argita Malltezi	Prof. Dr	Departamenti i Shkencave Juridike	PAK
11	E Drejtë e Punës e Krahasuar	Aldo Shkëmbi	Dr	Departamenti i Shkencave Juridike	PAE